GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7408 E shtunë 13 Janar **2018** **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**

KORÇA BEER edhe sot më e mira ...

Dje *në* 'Deutsche Welle'

Natyrisht që unioni konservator mund të bashkëpunojë me SPD, por në fakt ato nuk e duan një gjë të tillë. E kjo është vështirësia. Por një rol vendimtar në këtë... Vijon në faqen 22

Nga CHRISTOPH STRACK

Të nxitur për rezultate, CDU, CSU dhe SPD, ujdi për koalicion

Opinioni *i* Ditës

Sot Policia e Shtetit ka datëlindjen, ajo bën 105 vjeç, një moshë kjo e denjë për nderim dhe respekt. Ka qenë 13 janari i vitit 1913, kur qeveria e burrit të madh, Ismail... Vijon në faqen 21

Nga BESNIK BAKIU

Policia që meritojmë

Ministrja e Drejtësisë: Shkarkim e hetim për 2 gjyqtarë

Lu: Ofrojmë prokurorë të FBI për hetimin e Tahirit. Vëmendje edhe 'Shullazit' e 'Berishës'

"Kjo çështje kërkon një hetim të plotë dhe proces të paanshëm ligjor"

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të gatshme të ofrojnë prokurorë të FBI-së për hetimin e çështjeve të korrupsionit të nivelit të lartë, siç cilësohet ajo ku është i përfshirë edhe ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri. Deklarata e fortë u bë dje nga ambasadori i SHBA-ve, Donald Lu, i pyetur nga "BalkanWeb"... Në faqen 3

NIS PROCEDURA PER KOMPENSIMIN FINANCIAR TE TOKAVE TE ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE

ATP: LISTA ME 470 PRONARE QE U NDAHEN 300 MLN LEKE

Agjencia e Trajtimit të Pronave: Formulari TIP e 6 dokumentet që duhet të dorëzohen. Përfituesit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Dibër, Elbasan, Korçë...



(Në foto) **Foto ilustruese. Faksimile e formularit TIP , që vihet në dispozicion nga ATP** Në faqet 8-11

MBLEDHJA E QEVERISE

Rama: Mjekët që shkojnë aty ku ka mungesa do të marrin 2.5 mln lekë bonus. Drejtorët, në provë

Në faqen 4

BISEDIME EDHE PER INTEGRIMIN

Presidenti Meta i kërkon homologes kroate: Të gjendet një zgjidhje për Ballist Morinën

Në faqen 5

FINANCIMI

Radioterapia dhe kataraktа, paketat e reja që do të mbulohen nga shteti dhe privati

Në faqen 12

"NDERI I KOMBIT"

Shuhet Rexhep Çeliku, Lili Cingu: Ja amaneti i fundit që la para ikjes

Në faqen 20

PUSHIMET LUKS TE ANGELA MARTINIT

Sara Kapo: Eros apo vulgaritet? Cili është limiti im. Kur do vijë provokimi i radhës

Suplement

INTERVISTA/ Deputeti i PD-së denoncon politikat qeverisëse: Ditë të zeza për shqiptarët

Protesta, Shehu: Prej varfërisë, shpërthim spontan

"LSI, parti e rëndësishme. Jo aleancë, por bashkëpunim kundër Ramës"

Nga VALENTINA MADANI

Tritan Shehu, deputet i PD-së denoncon ashpër politikat e qeverisë "Rama" për shëndetësinë ndërsa e bën atë përgjegjës direkt për varfërimin e tejskajshëm të shqiptarëve. Nisur nga kjo, z.Shehu tregon për "Gazeta Shqiptare" arsyet se pse shqiptarët do të protestojnë më 27 janar. Sipas tij, ky shpirt proteste tani duhet të orientohet në kanalet e një lëvizjeje të madhe demokratike popullore, produktive, e cila vetëm kështu do të japë efektet thellësisht... Në faqet 6-7

DOSJET E MEDHA
REAGIMET

Pesë ish-punonjës padisin në gjykatë Etilda Gjonajn, shkak largimi nga puna

Ministrja e Drejtësisë, kërkesë KLD: Të shkarkohet gjyqtari Curri

"Hetim disiplinor për gjyqtaren Enkeleida Hoxha"

Ina Allkanjari

Pas lëvizjeve të kryera së fundmi në prokurori nga Arta Marku, tashmë edhe ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, ka kërkuar shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Durrësit, Petraq Curri dhe fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares së Gjykatës së Krujës, Enkeleida Hoxha. Këtë kërkesë Gjoni ia ka paraqitur zyrtarisht Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në përfundim të hetimit disiplinor të zhvilluar ndaj gjyqtarit Curri, Ministria e Drejtësisë ka konstatuar shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë figurën e tij. Bëhet fjalë për rastin e të pandehurit Alket Hatiaj, i cili u lirua në korrik të vitit të kaluar nga ky gjyqtar. Hatiaj kërkohet nga Italia për trafik heroine dhe kokainë, dhe ishte pikërisht gjyqtari Curri, i cili nuk pranoi kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurisë arrest me burg ndaj tij me qëllim ekstradimin. Në lidhje më këtë vendim, më herët gjykata e Durrësit ka arsyetuar se kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" për efekt të ekstradimit ndaj të pandehurit Alket Hatiaj, ka qenë e pabazuar. Kjo pasi kërkesa nuk shoqërohej me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" për shtetasin Alket Hatija për efekt të ekstradimit, kërkesë kjo e cila është kusht për caktimin e masave shtrënguese për efekt të ekstradimit. Sakaq Ministrja Gjonaj, ka kërkuar hetim disiplinor edhe për gjyqtaren e Krujës, Enkelieda Hoxha. Kjo gjyqtare nëntorin e kaluar ka vendosur lirimin me kusht të të dënuarit Genc Tafili në kundërshtim me dispozitën ndaluese të ligjit.

Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

ISH-PUNONJËSIT
Padia është depozituar në gjykatë nga punonjësit Petrit Bakiu drejtor i Financës, Bledar Kabashi drejtor i Inspektimit, Gerhard Qafa inspektor, Valbona Kryemadhi përgjegjëse sektori dhe Arlind Arapi shef sektori në Inspektim.

ALKET HATIAJ
Në përfundim të hetimit disiplinor të zhvilluar ndaj gjyqtarit Curri, Ministria e Drejtësisë ka konstatuar shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë figurën e tij. Bëhet fjalë për rastin e të pandehurit Alket Hatiaj, i cili u lirua në korrik të vitit të kaluar nga ky gjyqtarë. Hatiaj kërkohet nga Italia për trafik heroine dhe kokainë, dhe ishte pikërisht gjyqtari Curri i cili nuk pranoi kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurisë arrest me burg ndaj tij me qëllim ekstradimin.

GENC TAFILI
Ministrja Gjonaj ka kërkuar hetim disiplinor edhe për gjyqtaren e Krujës, Enkelieda Hoxha. Kjo gjyqtare nëntorin e kaluar ka vendosur lirimin me kusht të të dënuarit Genc Tafili në kundërshtim me dispozitën ndaluese të ligjit. Ai së bashku me të vëllanë, Admir Tafilin u dënuan për vrasjen e komisarit të policisë Arben Zylyftari. Genc Tafili kreu 17 vite burg nga 25.

Dritan Rreshka firmos lëvizjet e para te Prokuroria e Tiranës

Pas ndryshimeve të bëra në organin e akuzës në Tiranë, ku Arta Marku caktoi Dritan Rreshkën prokuror të ri në kryeqytet, ky i fundit ka firmosur ndryshimet e para. Në prokurorinë e Tiranës, Valentin Preçi dhe Kaso Berberi komandohen shefa seksioni. Preçi shkon shef i seksionit kundër pronës dhe Kaso Berberi shef i ekzekutimeve të vendimeve penale. Ndërkohë Prokurori Gjergj Tako nga prokuror i ekzekutimeve penale, kalon prokuror i thjeshtë. Sakaq Arben Nela dhe Erion Pano vazhdojnë të mbajnë postin e zv/prokurorit të Tiranës. Lëvizjet në prokurorinë e Tiranës vijnë pas furtunës së Arta Markut në rradhët e prokurorive në

Dritan Rreshka

emëruar, Dritan Ginës, drejtues i komanduar i prokurorisë së Elbasanit. Drejtues i përkohshëm i prokurorisë së Elbasanit u caktua Ardjan Nezha. Iu ndërpre komandimi Pali Deçolli, drejtues i komanduar i prokurorisë së Fierit. Në vend të tij u caktua Fatmir Lushi. Iu ndërpre komandimi prokurorit të rrethit gjyqësor Kukës, Artur Ismailukaj dhe në vend të tij u caktua Alketa Nushi.

Ai së bashku me të vëllanë, Admir Tafilin u dënuan për vrasjen e komisarit të policisë Arben Zylyftari. Genc Tafili kreu 17 vite burg nga 25. Pritet që KLD-ja të mblidhet në ditët në vijim për të vendosur mbi kërkesat e Ministres së Drejtësisë. Ndërkohë bëhet me dije se Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj është paditur nga 5 ish-punonjës për shkak të largimeve nga puna.

PADIA

Largimet nga puna pranë Ministrisë së Drejtësisë, kanë sjellë reagimet e pesë ish-punonjësve ndaj Etilda Gjonaj. Bëhet me dije se këto persona, të cilët janë ish-punonjës në disa sektorë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, kanë paditur ministren Gjonaj dhe kërkojnë shfuqizimin e urdhrit për largimet e tyre nga puna. Padia është depozituar në gjykatë nga punonjësit Petrit Bakiu drejtor i financës, Bledar Kabashi drejtor inspektimi, Gerhard Qafa inspektor, Valbona Kryemadhi përgjegjëse sektori dhe Arlind Arapi shef sektori në inspektim.

Ja emrat më të përfolur

Policia, hapet konkursi për pasuesin e Çakos

Prej tre ditësh Policia e Shtetit ka nxjerrë një ur dhër për hapjen e konkursit që mundëson marrjen e gradës "Drejtues i parë". Në konkursin e hapur me urdhër të drejtorit të komanduar Rebani Jaupi, theksohet se janë 5 vendet r lira për gradën "Drejtues i parë". Bëhet me dije se konkursi do zhvillohet nga Akademia e Sigurisë dhe deri në datën 16 janar aplikuesit duhet të dorëzojë dokumentacionin për të fituar gradën. Akademia e Sigurisë do të përzgjedhë 5 kandidaturat duke u bazuar në disa kritere, duke filluar nga karriera në Policinë e Shtetit, trajnimet dhe të gjitha vlerësimet që kanë kandidatët. Urdhri parashikon që aplikantët të dorëzojnë dokumentacionin deri më 16 janar dhe më pas Akademia e Sigurisë të zhvillojë procesin e konkurrimit që do të thotë se gradat do të jepen në një afat kohor brenda 2 javësh. Deri më tani për Drejtor të Policisë së Shtetit përfliten disa emra, mes tyre Ardi Veliu, drejtor i policisë Tiranë, Eduart Merkaj kreu i SHÇBA, Gjovalin Loka, drejtor i policisë së Shkodrës, por edhe disa drejtues të tjerë në radhët e uniformave blu.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Fituesi pritet të zyrtarizohet ditën e hënë, ka edhe vlerësime negative

'KLP', ONM dorëzon në Kuvend rekomandimet për 4 kandidatët e shoqërisë civile

Vëzhguesit e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) dorëzuan dje, rekomandimet për katër kandidatët e shoqërisë civile për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Këtë gjë e ka bërë të ditur kryetarja e ONM, Genoveva Ruiz Calavera në një status në "Twitter". Sipas burimeve mes kandidatëve ka pasur edhe vlerësime negative, pavarësisht se nuk dihet për cilin prej tyre. Kandidati fitues pritet të zyrtarizohet ditën e hënë. Entela Hoxhaj nga shoqëria civile është renditur e para në listën e kandidatëve. "Vëzhguesit e Operacionit Monitorues Ndërkombëtar ofrojnë rekomandime për kandidatët e shoqërisë civile për vendet në Këshillin e ri të Prokurorit të Lartë. Vendimtare të ecim përpara me formimin e organeve vetëqeverisëse në gjyqësor", shkruan Calavera, në rrjetin social, "Twitter". Për këtë pjesë të reformës në drejtësi pati edhe një ngërç, pikërisht nga shoqëria civile. Procesi i krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka filluar që në janar të vitit 2017. Shkak për moskrijimin e KLP-së është Shoqëria Civile. Fakti që ende nuk ka një kandidat konkret nga Shoqëria Civile, vjen edhe për shkak se kriteret janë të forta. Javën e ardhshme priten edhe rezultatet e para për Këshillin e Lartë të Prokurorisë lajmëroi një ditë më parë nënkryetarja socialiste e Kuvendit, Vasilika Hysi. "Tashmë është përgatitur programi trejavor i punimeve të Kuvendit dhe është futur edhe shqyrtimi i kandidaturave për KLP", tha deputetja Vasilika Hysi.



SHEFJA E ONM
"Vëzhguesit e Operacionit Monitorues Ndërkombëtar ofrojnë rekomandime për kandidatët e shoqërisë civile për vendet në Këshillin e ri të Prokurorit të Lartë. Vendimtare të ecim përpara me formimin e organeve vetëqeverisëse në gjyqësor", shkruan Calavera, në rrjetin social "Twitter".

Ambasadori i SHBA: Po ndjekim edhe çështjet e Shullazit apo Lul Berishës. Edhe Vlahutin në zyrën e Xhafajt

Lu: Ofrojmë prokurorë të FBI për hetimin e Tahirit

"Kjo çështje kërkon një hetim të plotë dhe proces të paanshëm ligjor"

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të gatshme të ofrojnë prokurorë të FBI-së për hetimin e çështjeve të korrupsionit të nivelit të lartë, siç cilësohet ajo ku është i përfshirë edhe ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri. Deklarata e fortë u bë dje nga ambasadori i SHBA-ve, Donald Lu, i pyetur nga "BalkanWeb", në përfundim të një takimi me ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj në prani edhe të ambasadores së BE-së, Romana Vlahutin. Ndërsa bëhej fjalë për një takim që zgjati rreth 1 orë e 30 minuta, "BalkanWeb" u interesua për temat për të cilat kishin diskutuar ambasadorët në zyrën e ministrit dhe zoti Lu u tregua i gatshëm të ndajë opinionin e tij. Sipas kreut të diplomacisë amerikane, çështja e zotit Tahiri kërkon një hetim të plotë dhe proces të paanshëm ligjor, e në këtë pikë SHBA-të janë të gatshme të ofrojnë edhe prokurorë të FBI-së për ta hetuar. Lu nuk ka nguruar të komentojë se ambasada vijon të ndjekë nga afër edhe çështje të tjera sensitive, si ato Emiljano Shullazit, Lul Berishës dhe tre gjykatësve të Apelit në Durrës. Gazetarja e "BalkanWeb" e pyeti ambasadorin Lu se a kishte biseduar gjatë takimit me ministrin e Brendshëm, Xhafaj, për çështje korrupsioni të nivelit të lartë, si ajo e Saimir Tahirit. Në përgjigjen e tij, Lu u shpreh: "Çështja e Z. Tahiri kërkon një hetim të plotë dhe proces të paanshëm ligjor. Ashtu si vetë z. Tahiri dhe shumë udhëheqës të tjerë shqiptarë e kanë thënë, kjo çështje duhet zgjidhur në gjykatë, duke shqyrtuar të gjitha faktet. Bota, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara po e ndjek nga shumë afër këtë çështje dhe çështje të tjera sensitive, si ato të Emiljano Shullazit, Lul Berishës dhe tre gjykatësve të Apelit në Durrës. Ne kemi ofruar mbështetjen e prokurorëve federalë amerikanë dhe agjenci të zbatimit të ligjit të Shteteve të Bashkuara për t'i ofruar ndihmë teknike Prokurorisë në kryerjen e një hetimi të plotë, i cili ka për qëllim zbulimin e të vërtetës. Ne do donim të shihnim një hetim më aktiv nga prokurorët dhe policia gjyqësore, dhe e kemi përcjellë këtë mesazh. Në një demokraci të vërtetë, askush nuk është mbi ligjin", u shpreh ambasadori. Takimi i ambasadorit Lu vjen një ditë pasi në Ministrinë e Brendshme u mblodh për herë të parë task forca ndërinstitucionale për goditjen e grupeve të strukturuara kriminale. Në zyrën e ministrit të Brendshëm për këtë çështje ishte dhe ambasadorja e BE-së, Romana Vlahutin, ndërsa kryeprokurorja e përkohshme Arta Marku priti ekspertë të EURALIUS, të cilët do të ofrojnë ndihmë në hetimin e dosjeve të nxehta të drejtësisë Shqiptare.

DEKLARATA
"Ne do donim të shihnim një hetim më aktiv nga prokurorët dhe policia gjyqësore dhe e kemi përcjellë këtë mesazh. Në një demokraci të vërtetë, askush nuk është mbi ligjin", u shpreh ambasadori.

Prokuroria merr në pyetje shoferin e dytë të ish-ministrit

A takoi Tahiri Habilajt? Aliaj rrëfen kontaktet gjatë pushimeve në Greqi

Prokurorët morën dje në pyetje shoferin e dytë të ish-ministrit Saimir Tahiri. Shtetasi Alban Aliaj, shoferi i dytë i ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, që më herët ka qenë punonjës i Gardës së Republikës është thirrur nga prokurorët që po hetojnë dosjen "Tahiri-Habilaj". Emri i Aliajt ka dalë pas këqyrjes në sistemin TIMS. Gjatë muajit gusht 2014, Alban Aliaj ka shkuar në Greqi me një automjet zyrtar. Në të njëjtin moment ka shkuar në Greqi edhe Artan Habilaj, në bordin e "Audi"-t AA 003 GB. Gjatë pyetjeve në prokurori, ish-shoferi i Tahirit ka pranuar se Artan Habilaj ka mbërritur në Greqi dy ditë pasi ministri Tahiri ndodhej në plazh me bashkëshorten. Pas takimit mes të dyve, automjeti "Audi" AA 003 GB me të cilin udhëtoi Artan Habilaj qëndroi në Greqi, kurse vetë Habilaj u kthye në Tiranë me ish-shoferin e Tahirit. Në dëshmitë e tij Saimir Tahiri ka këmbëngulur se automjetin "Audi" e ka shitur që prej 2013-ës dhe se nuk ka pasur kontakt me Habilajt. Kurse ngjarja për të cilën prokurorët kanë siguruar dëshminë e ish-shoferit ka ndodhur në 2014-ën. Burimet nuk konfirmojnë se për çfarë u shërben kjo dëshmi prokurorëve, të cilët nuk e kanë vendosur ende se kur do ta marrin në pyetje vetë ish-ministrin Tahiri. Por, me gjithë numrin e lartë të të pyeturve, ku nuk kanë munguar edhe zyrtarë të lartë policie, prokuroria e humbi betejën paraprake në gjykatë për ndalimin e daljes jashtë shtetit të Saimir Tahirit si edhe për arrestin me burg të Orest Sotës, biznesmenit që iu gjetën në automjet patentat detare të ish-ministrit dhe mbi 860 mijë euro.

SITUATA POLITIKE
REAGIMET

LSI mbledh grupin parlamentar, vendos 3 prioritetet e saj

Luan Rama: Integrimi, "drejtësia" e zgjedhjet, vija e demarkacionit me të tjerët

Grupi parlamentar i LSI-së vendosi dje të marrë pjesë në seancën e datës 15 janar në çelje të sesionit të ri të Kuvendit, për të ushtruar me vendosmëri të gjitha përgjegjësitë e përfaqësimit në Kuvendin e Shqipërisë. Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama deklaroi pas mbledhjes se grupi mbështeti vendimin e kryesisë së LSI-së për t'u bërë pjesë e protestës së datës 27 janar dhe sipas tij, "është tërësisht i angazhuar për të sjellë në këtë protestë jo vetëm revoltën qytetare, por edhe shqetësimin qytetar dhe problematikën e madhe me të cilën ballafaqohen qytetarët tanë në të gjithë vendin". "LSI dhe grupi i saj parlamentar është në të njëjtën linjë, duke evidentuar si prioritetet apo si kredon politike të vitit 2018

Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama

për Lëvizjen Socialiste për Integrim, integrimin europian të vendit dhe ne jo vetëm do të ushtrojmë presion mbi qeverinë dhe të gjitha strukturat e saj, por do të jemi kontribuues aktivë dhe të vendosur që Shqipëria të çelë negociatat me Bashkimin Europian, si tregues i seriozitetit, i angazhimit dhe i përgjegjësisë që ne kemi përballë qytetarëve shqiptarë dhe interesave europiane të vendit", tha Luan Rama. Ai shpalosi 3 prioritetet e LSI-së, ku veç integrimit është edhe reforma në drejtësi dhe ajo zgjedhore. "Vija e demarkacionit midis nesh dhe të tjerëve është integrimi europian, reforma në drejtësi, reforma zgjedhore, interesi qytetar, interesi publik, interesi kombëtar i Shqipërisë europiane", tha ai.

LUAN RAMA
"Vija e demarkacionit midis nesh dhe të tjerëve është integrimi europian, reforma në drejtësi, reforma zgjedhore, interesi qytetar, interesi publik, interesi kombëtar i Shqipërisë europiane".

Mbledhja e djeshme e qeverisë në Lezhë

Qeveria mblidhet në Lezhë, opozita proteston në Torovicë: Tepsinë do ta çoj për skrap

Rama: Krerët e burgjeve, spitaleve e hipotekave, 3 muaj provë

"Mjekët që shkojnë aty ku ka mungesa do të marrin 2.5 mln lekë bonus"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama i publikoi dje vetë vendimet e qeverisë, që këtë herë ndodhet në Lezhë për fundjavë. Kreu i qeverisë njoftoi se në bashkëpunim me kryetarët e bashkive në rang vendi është përcaktuar një listë me 100 fshatra, ku do të stimulohet zhvillimi i integruar rural. Ai zbuloi se Fishta e Lezhës është prej këtyre 100 fshatrave. Ai bëri me dije se një tjetër vendim është projekti i rrugës kombëtare Milot-Balldren, me të gjitha veprat e artit dhe me tunelin që mundëson kalimin. Po kështu, qeveria do të mundësojë edhe ndërtimin e aksit të ri që do të lidhë Shëngjinin me Velipojën dhe do të mundësojë integrimin e të gjithë asaj zone me një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit, siç u shpreh Rama. Kryeministri tha se në mbledhje kishin diskutuar edhe për një numër projektesh infrastrukture pikërisht për zonën e Shëngjin-Velipojës, që përfshihen në një program të posaçëm investimesh për zhvillimin rural me përparësi turizmin, pro-

Kryeministri Edi Rama

jektin e rindërtimit të terminalit të pasagjerëve dhe të hyrjes në Portin e Shëngjinit, si dhe projektin e rrugës nga Balldreni në Malin e Jushit, ose siç e quajnë lezhjanët, rrugën e Torovicës. "Më vjen shumë mirë që më në fund, ata që e kishin pas marrë përsipër për ta bërë këtë rrugë po interesohen, duke stimuluar protesta dhe i përshëndes, sepse kjo do të thotë që pavarësisht kësaj, kur e kishin në dorë ta bënin rrugën, i bënë asaj atë që s'thuhet. Tani duan që rrugën ta bëjnë përmes nesh", u shpreh Rama, duke i kthyer një përgjigje edhe opozitës, e cila e priti me protesta pikërisht në Torovicë.

MEMORIALI
Në mbledhjen e qeverisë është vendosur një program i plotë restaurimi i memorialit të Gjergj Kastriot Skënderbeut. "Ne kemi bërë sa kemi mundur dhe gjendja e sotme e memorialit lë shumë për të dëshiruar në raport me atë që duhet të jetë", tha dje Rama.

REFORMA E UJIT

Rama njoftoi edhe vendimin e qeverisë për të subvencionuar nga shteti kontratat dhe vendosjen falas të matësve të ujit për të gjitha familjet në nevojë. Sipas tij, familjet në nevojë, përveçse do të marrin matësit pa pagesë, do të shpëtojnë nga barra e aforfeve, sipas tekave të faturistëve lokalë dhe njëkohësisht do të mund të shërbehen më mirë sesa deri sot. Në fund të vendimeve që ai publikoi, njoftoi se të gjithë ata mjekë që do të shkojnë në ndihmë të komuniteteve jashtë zonave të mëdha të banuara ku është nevoja për mjekë specialistë në spitale, qofshin rajonale, qofshin bashkiake do t'u jepet bonusi deri në 2.5 milionë lekë (të vjetra) mbi rrogën. I pyetur nga gazetarët lezhjanë në lidhje me emërimet e drejtorëve në spitale e hipoteka, Rama u shpreh: "Vendosmëria ime për t'i shkuar deri në fund procesit të çuarjes së tepsisë për skrap është më e madhe seç ishte kur jam zotuar për këtë dhe do të jetë çdo ditë e madhe, pasi vështirësia në këtë proces nuk është se do të jetë më e vogël, por është çdo ditë e më e madhe. Ndërkohë që mos harroni, të gjitha pozicionet ku ne po bëjmë ndryshime kanë kushtin e provës. Pra, kemi drejtorë të rinj në spitale, janë 3 muaj në provë. Kemi drejtorë të rinj në burgje, janë 3 muaj në provë. Kemi drejtorë të rinj në hipoteka, janë 3 muaj në provë e kështu me radhë. Është një sfidë", tha Rama. Ndërkohë, pas mbledhjes Rama ishte së bashku me ministren e Kulturës dhe kreun e Bashkisë së Lezhës, që i përket Partisë Demokratike në Lezhë, në prezantimin e projektit të rehabilitimit të plotë të memorialit të varrit të Skënderbeut në rrënojat e Kishës së Shën Kollit. "E kam parë edhe më të mjerë memorialin, se e kam vizituar në shoqërinë e deleve që hanin plehra. Si ministër Kulture në atë kohë i dhashë jetë një projekti të parë për memorialin, më pas si kryeministër mbështeta një projekt tjetër, që solli rindërtimin e qendrës dhe sistemimin pjesor përreth memorialit dhe sot, ne do flasim për projektin për vetë memorialin që do të rilindë, siç i ka vërtetë hije Lezhës dhe siç me të drejtë, edhe ju e dëshironi.

Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

Permbaruesi gjyqesore **Genti Bushati** nxjerr per shitje ne ankand pasurine :
"Toke Are truall nr pasurie 222/11, vol 4 , faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trush , Njesia Administrative Berdice , bashkia Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren 515,200 (peseqind e pesembedhjetemije e dyqind) leke
Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date **15.01.2018 ora 16.16** ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURINË NR. 2/963-ND+1-43 , E LLOJIT 'APARTAMENT' , VOLUMI 55 , FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513 , ME SIPËRFAQJE 67,81 M2 , NË ADRESËN : RRUGA "K. KËRTUSHA" , SHKALLA 1 , KATI 7 , DURRËS , NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .
ÇMIMI 2.800.000 LEKË ", Data e zhvillimit të ankandit do jetë 19.01.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Presidenti diskuton me homologen kroate për Ballist Morinën: Të gjendet një zgjidhje

Ilir Meta: Agjendë gjithëpërfshirëse dhe afate konkrete anëtarësimi në BE

Presidentët do të vizitojnë komunitetin e Arbanasve të Zarës

Darina Tanushi

Presidenti Ilir Meta nisi dje një vizitë zyrtare në Kroaci. Ai u takua së pari me homologen e tij, Kolinda Grabar-Kitarovi. Në fokus të këtij takimi kanë qenë disa tema, duke veçuar marrëdhëniet mes dy shteteve dhe të ardhmen e tyre. Po ashtu, mësohet se në fokus të takimit ka qenë dhe Ballist Morina, i cili ndodhet i arrestuar në këtë vend. Meta dhe Kitarovic kanë diskutuar për Morinën për të gjetur një zgjidhje për këtë rast. President Meta në kohën kur Ballist Morina ishte drejt ekstradimit në Serbi, thirri në një takim ambasadoren kroate në Shqipëri. Pas këtij takimi, Kroacia vendosi që të mos lejonte ekstradimin e Morinës për në Serbi. Gjatë bisedës me homologen kroate,

Presidenti Meta shprehu mirënjohjen e thellë për mbështetjen e fortë që Presidentja Grabar-Kitarovi? dhe Kroacia i kanë dhënë Shqipërisë, veçanërisht në kuadër të procesit të integrimit evropian. Duke iu referuar lidhjeve të forta historike dhe marrëdhënieve të shkëlqyera midis dy vendeve, si dhe vizionit të përbashkët euroatlantik, Presidenti Meta theksoi se ka ardhur koha që këto marrëdhënie të ngrihen në nivelin e Partneritetit Strategjik. Presidenti Meta vlerësoi në mënyrë të veçantë rolin dhe kontributin e komunitetit shqiptar, që jeton në Kroaci si urë lidhëse në forcimin e marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve. Të dy presidentët ranë dakord që në kuadrin e Vitit të Skënderbeut, të zhvillojnë një vizitë të përbashkët tek komuniteti 300-vjeçar i Arbanasve të Zarës. Të dy presidentët theksuan domosdoshmërinë e vijimit të procesit të zgjerimit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vlerësuan rolin shumë të rëndësishëm që mund të luajë në këtë drejtim Procesi i Brdo-Brijunit. Presidenti Meta shprehu besimin në mbështetjen e Kroacisë për çeljen së shpejti të negociatave të anëtarësimit në BE, mbështetje shumë e rëndësishme për Shqipërinë dhe inkurajuese për vijimin e reformave dhe përmbushjen e kritereve të nevojshme. "Është jetike për Shqipërinë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor një agjendë gjithëpërfshirëse dhe afate konkrete anëtarësimi në BE", - nënvizoi Presidenti Meta. Z. Meta dhe Kitarovi? ranë dakord që vizita shtetërore e Presidentes kroate në Shqipëri të zhvillohet në muajt në vijim.

Presidenti Ilir Meta dje në Kroaci me homologen e tij, Kolinda Grabar-Kitarovi

INTEGRIMI
Presidenti Meta shprehu besimin në mbështetjen e Kroacisë për çeljen së shpejti të negociatave të anëtarësimit në BE, mbështetje shumë e rëndësishme për Shqipërinë dhe inkurajuese për vijimin e reformave dhe përmbushjen e kritereve të nevojshme.

BASHKEPUNIMI
Presidenti Meta vlerësoi në mënyrë të veçantë rolin dhe kontributin e komunitetit shqiptar, që jeton në Kroaci si urë lidhëse në forcimin e marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve. Të dy presidentët ranë dakord që në kuadrin e Vitit të Skënderbeut, të zhvillojnë një vizitë të përbashkët tek komuniteti 300-vjeçar i Arbanasve të Zarës.

Ministri i Jashtëm në Suedi: Të vendosur të vijojmë reformat

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, mori dje nga homologia suedeze mbështetjen në rrugën e reformave në të cilën po ecën vendi. Gjatë bisedës me ministren e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Suedisë, Margot Wallström, Bushati diskutoi mbi dinamikën e shkëlqyer të marrëdhënieve dypalëshe. Ministri Bushati vlerësoi rolin mbështetës të Suedisë për procesin e zgjerimit në përgjithësi dhe përpjekjeve të Shqipërisë në veçanti në këtë proces. Ai e njohu kolegen suedeze me hapat dhe masat e ndërmarra nga qeveria në procesin e reformave dhe plotësimin e pesë kritereve kryesore në kuadër të BE-së, duke konfirmuar vendosmërinë e qeverisë shqiptare për "zbatimin e reformës në drejtësi dhe procesin e vetingut". Ministri Bushati shprehu besimin se, "viti 2018 do të jetë një vit i rëndësishëm në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë", përmes vendimit të vendeve anëtare për hapjen e negociatave për anëtarësim. Ministrja Wallström konfirmoi qëndrimin mbështetës të Suedisë për Shqipërinë dhe vlerësoi përpjekjet e qeverisë në procesin e reformave. "Jeni në rrugën e duhur dhe keni mbështetjen tonë", nënvizoi ministrja suedeze.

2018-ta, viti i sprovës për Shqipërinë

Viti 2018 duhet konsideruar një vit kyç për Shqipërinë. Vendi është shumë pranë çeljes së negociatave të anëtarësimit në muajt në vijim, që do të jenë vendimtare për rrugën drejt BE-së. Tabloja do të përvijohet më qartë në muajin prill, kur Komisioni Europian të paraqesë progres-raportin për Shqipërinë. Por, ndërsa pritet për t'u parë se çdo ndodhë më pas, komisioneri i Zgjerimit, Johanes Hahn ndau me shqiptarët optimizmin se vlerësimet do të jenë pozitive dhe u kujtoi se nuk ka pasur 'feedback' negativ nga asnjë prej vendeve anëtare të bllokut. Përpos kësaj, komisioni nxjerr muajin e ardhshëm strategjinë e tij të zgjerimit, dokument ky me një vizion të qartë për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë siguristh edhe Shqipërinë. Pa harruar më tej se Brukseli e mirëpriti ngritjen e institucioneve të vetingut dhe i mëshoi rëndësisë që ka suksesi i tyre, si hap përpara drejt implementimit të reformës së drejtësisë në vend.

Qeveria miraton ligjin "Për diasporën", caktohet 18 dhjetori ditë kombëtare

Këshilli i Ministrave ka miratuar projektligjin "Për diasporën", ku detajohen rregullat dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën. Projektligji parashikon ndër të tjera krijimin e Qendrave kulturore për Diasporën, që do të ushtrojnë veprimtarinë në vendet me interes për diasporën e Republikës së Shqipërisë, të cilat do të hapen në marrëveshje me këto vende. Po ashtu, parashikohet që në Muzeun Historik Kombëtar të themelohet një pavion i veçantë për diasporën, ndërsa Biblioteka Kombëtare në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse për arsimin dhe kulturën do të mundësojë aksesin në fondin e librave online, pa pagesë, për edukimin dhe letërsinë, dedikuar interesave të diasporës. Ndërkohë, Radiotelevizioni Shqiptar do të sigurojë një kanal transmetimi me program radioteleviziv për diasporën. Shpenzimet për prodhimin e programeve të dedikuara për diasporën dhe transmetimin do të përballohen nga buxheti i shtetit. Për pjesëtarët e suksesshëm të diasporës do të akordohet çmimi "Ambasador i Kombit". Kriteret dhe mënyra e ndarjes së çmimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, data 18 dhjetor caktohet si Dita Kombëtare e Diasporës.

NJOFTIM ANKANDI
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT ARTAN SIMA

Datë 19/01/2018, ditën e Premte ,ora 16,00 perfundon ankandi i ri (i parë) , për shitjen e pasurisë së paluajtshme lenë garanci nga debitori z. Ramadan Ibrahim Kordallibanues ne Bilisht ,Bashkia"Devoll" për detyrimin ndaj kreditorit : znj.Lindita Bere Kordalli, banuese ne fshatin"Tren",Rrethi Devoll .
"Apartament" me sipërfaqe totale 73.40 m2 e ndodhur në Bilisht, në vlerën 1.440.000 lekë.

Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 .k,1. Korce.
Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT ARTAN SIMA

Datë 19/01/2018, ditën e Premte ,ora 16,00 perfundon ankandi i ri (i parë) , për shitjen e pasurisë së paluajtshme lenë garanci nga debitori z. Artur Dilaver Hasani dhe bashkpronaret z.Dilaver Ramo Hasani , z.Edmond Hasani , znj. Luiza Dilaver (Hasani) Hoxha banues ne,Rr" 28 Nentori" ,L.5,P.2,Shk.B,Nr.9, Korce për detyrimin ndaj kreditorit : z.Rexhep Shaban Furramani,Rr.Hasim Vokshi,L.7,Nr.35,Korce.
"Apartament" me siperfaqe 63.10 m2,ndodhur ne Rr"28-Nentori", pll.2, shk.2, k.5,ap.9, Korce, në vlerën 1.600.000 lekë.
Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 .k,1. Korce.
Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

1- "Truall" me sip. 200 m² nga kjo ndretese 114 m2,Nr. pasurie 9/584, Vol. 27, Faqe 87, ZK 8532 i ndodhur ne Sheq i Madh, Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është **9.472.000 Leke.** Ankandi per do te zhvillohet **datë 22.01.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane
2- "Are" me sip. 9.159 m², Nr. pasurie 117/37, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur ne Sheq , Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është **16.852.160 Leke.** Ankandi per do te zhvillohet **22.01.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane .
Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al.

PROTESTA E OPOZITES

INTERVISTA

Deputeti i PD-së denoncon politikat qeverisëse: Ditë të zeza për shqiptarët

Protesta, Shehu: Prej varfërimit mund të shpërthejnë spontanisht

"Me LSI jo aleancë, por bashkëpunim kundër Ramës"

Valentina Madani

Tritan Shehu, deputet i PD-së denoncon ashpër politikat e qeverisë "Rama" për shëndetësinë ndërsa e bën atë përgjegjës direkt për varfërimin e tejskajshëm të shqiptarëve. Nisur nga kjo, z.Shehu tregon për "Gazeta Shqiptare" arsyet se pse shqiptarët do të protestojnë më 27 janar. Sipas tij, ky shpirt proteste tani duhet të orientohet në kanalet e një lëvizjeje të madhe demokratike popullore, produktive, e cila vetëm kështu do të japë efektet thellësisht pozitive e ndryshuese të gjithanshme, të domosdoshme këto për vendin. "Vetëm kështu mund të evitohet rreziku real që kjo protestë të shpërthejë spontanisht dhe në mënyrë kaotike, me shumë dëme të paparashikuara", shprehet z.Shehu.

Tritan Shehu, deputet i PD-së

Z.Shehu, shëndetësia po del në qendër të vëmendjes përsëri. Si e konsideroni ju gjendjen e këtij sistemi te ne?

Nuk ka si të ndodhë ndryshe. Kjo, edhe sepse pa as më të voglin dyshim, sistemi i ynë shëndetësor pas 4,5 vite Rilindje po shkon drejt kolapsit të plotë. Shumë shpejt ai kështu do të krahasohet vetëm me gjendjen e vendeve të Afrikës Qendrore, ku për shumicën e popullsisë nuk bëhet fjalë për shëndetësi. Dhe kjo duket qartësisht nga dy elementë. Së pari, nga të dhënat objektive të sotme dhe së dyti, nga mospasja e asnjë strategjie zhvilluese të sektorit. Niveli aktual i shërbimit shëndetësor, kujdesi ndaj pacientit të një vendi matet nga disa indekse: nga niveli i financimeve për shëndetësinë, nga numri i mjekëve të përgjithshëm e specialistë, nga numri i shtretërve së bashku me numrin e specialiteteve të ngushta. Ndërsa, perspektiva nga fakti se sa reale e zhvilluese janë programet së paku afat mesme. Tek ne sot financimi publik për shëndetësinë është rreth 1,95% e GDP, ose ndryshe 85 euro për frymë popullsie në vit, shifër kjo 22 herë më e ulët se mesatarja europiane. Edhe po t'i shtojmë kësaj 0,85% të GDP nga kontributet direkte, që nuk janë fonde publike, ose rreth 35 euro për frymë, vazhdojmë të jemi shumë larg asaj që duhet. Nga ana tjetër nuk ka asnjë strategji optimiste, nuk ka asnjë të dhënë nga buxheti, qoftë dhe ide nga qeverisja të shprehur se si do të tejkalohet kjo varfëri e skajshme e shëndetësisë. Mbas harresës së termit shkatërrues "shëndetësi falas", askush nga mazhoranca nuk po artikulon më qoftë edhe një propozim për politikat financiare të sistemit shëndetësisë. Po kështu, mjekët te ne po bëhen një "specie në zhdukje" duke arritur në 1,1 mjek për 1000 banorë, nga rreth 4,5 që është mesatarja europiane. Paralelisht me këto, numri i shtretërve spitalore ka arritur në 2,4 shtretër për 1000 banorë në rënie, kur duhet të jemi së paku në 4 e i specialiteteve të ngushta, te ne është rreth 10 herë më i vogël se në vendet europiane. Që këtej deduksionet janë të qarta. Po largohet shërbimi shëndetësor nga popullsia, nga qytetarët, nga pacientët e zonat që janë bosh, pa mjekë familje e specialistë, po zgjerohen frikshëm. Si pasojë edhe spitalet po boshatisen dhe po koncentrohemi vetëm në Tiranë, ku edhe atje shërbimi lë shumë për të dëshiruar, qoftë edhe për shkak të mbingarkesës. Dhe në këtë drejtim po e çojnë jo vetëm në degradim të pakontrolluar të gjendjes, por dhe në mungesa të plotë e vizioneve apo "strategjitë" e gabuara të shpallura nga ministria përkatëse. Në fakt, ai material "programatik" i shpallur si i tillë, vetëm strategji zhvilluese nuk është. Me dy fjalë po shkohet "me hapa të sigurta" drejt modelit më të prapambetur shëndetësor, drejt atij afrikan, në të gjitha aspektet.

Megjithatë, kryeministri Rama ka folur së fundmi për masa rregulluese, emërime infermierësh, stazh mjekësh, riformatim spitalesh etj...

Po, është e vërtetë që ka folur, por nuk ka thënë asgjë nga ato që duhet të thotë. Në tërësi ai është përpjekur të lëshojë fishekzjarrë e të përsërisë atë "shfaqje" që bëri dikur me spekulimin "shëndetësi falas". Ai nuk ka artikuluar më kryesoren, se si do të krijojë e cilat do të jenë kolonat e një sistemi, financimi stabël e autonom për shëndetësinë së paku për të kaluar varfërinë. E vetmja risi në këtë pikë është se ai nuk përmend më "shëndetësinë falas", ndërsa rithekson rritjen e shpenzimeve për "koncesionet" abuzive, ose më shumë pak rentabilitet klinik, që veçse e varfërojnë më tej sistemin. Po kështu, nuk ka paraqitur asnjë strategji se si do të përballohet ulja galopante e numrit të mjekëve, specialistëve etj., si do të rriten këto shifra në të ardhmen. E vetmja gjë që është thënë në këtë kontekst është se do të organizohet një "stazh" apo "qarkullim" i mjekëve të qendrës drejt periferisë me zona "patronazhi". Këto janë ide të tejkaluara na kujtojnë patronazhin e dikurshëm me "brigadat kulturore" apo të specialiteteve të tjera, që çoheshin në bazë gjatë diktaturës. Janë mekanizma anakronike, që vetëm regjimet e revolucionet si ai "kultural" i përdornin. Po kështu, këto janë vendime të kundërligjshme, bien ndesh me Kodin e Punës, të drejtën, ligjet e tjera përkatëse, si dhe me kontratat që mjekët e spitaleve apo pedagogët kanë firmosur me institucionet e tyre. Në tërësi efekti i këtyre metodave "revolucionare" është veçse negativ, ato nuk përmbajnë asgjë vizionare e zhvilluese, qoftë dhe afat shkurtër apo mesëm, përderen vetëm si propaganda banale. Improvizime të tilla jo vetëm nuk zhvillojnë periferinë, por shkatërrojnë edhe institucionet qendrore. Gjithashtu, para pak ditësh dëgjova edhe për një ide tjetër, tejet centraliste e abuzive kjo, krijimin e një "portali qendror" për të gjitha emërimet e infermierëve në vend. Kjo, që ngjan me një drejtori kuadri në Tiranë me "drejtor" kryeministrin, ia kalon jo vetëm komunizmit, por edhe më kujtoi "portalin e mësuesve" të z.Rama, që tashmë askush nuk e përmend. Ideja e tretë, që kam veçuar nga këto deklarime "strategjike" është dhe shndërrimi i spitaleve periferike të ashtuquajtura "bashkiake" në qendra shërbimesh, që do të thotë se maksimumi këta do të kenë vetëm shtretër ditor, pra nuk do të jenë me spitale, duke larguar më tej shërbimin nga qytetari. Këtu dua të theksoj se koncepti "spital bashkiak apo rajonal" është një koncept i vjetruar, i tejkaluar. Spitali është veçse spital kudo që është, duke ofruar te pacienti të njëjtën cilësi shërbimi dhe që funksionon autonom si një "ndërmarrje". Pra, të gjitha këto "teori" e deklarata qeveritare janë bosh, thuhen veçse për të krijuar iluzione, ngrihen mbi një mentalitet të rrezikshëm tejet centralist, pa asnjë premisë zhvillimi dhe që jo vetëm mbajnë sistemin tonë shëndetësor në nivelet tragjike ku është, por e shtyjnë më tej atë drejt kolapsit të plotë. Besoj se tani të gjithë biem dakord, kur për një sektor si shëndetësia, gjendja aktuale është tragjike dhe nuk ekziston nga qeveria asnjë vizion real zhvillues, perspektiva nuk mund të jetë tjetër veçse "e zezë"!

REZULTATI

"Ky shpirt proteste tani duhet të orientohet në kanalet e një lëvizjeje të madhe demokratike popullore, produktive, e cila vetëm kështu do të japë efektet thellësisht pozitive e ndryshuese të gjithanshme, të domosdoshme këto për vendin. Vetëm kështu mund të evitohet rreziku real, që kjo protestë të shpërthejë spontanisht dhe në mënyrë kaotike, me shumë dëme të paparashikuara", tha z.Shehu.

Çfarë propozoni ju për ndryshimin e situatës nga e "zezë" në të "bardhë"?

Unë mendimet e mia i kam publikuar qartë. Ne si PD kemi edhe një program të plotë të daljes nga katastrofa e për zhvillimin e sistemit tonë shëndetësor me masa e ndryshime radikale. Gjithsecili mund ta lexoje atë. Megjithatë, meqenëse ju më pyesni, po ju përmend shumë shkurt disa nga idetë që unë kam hedhur: a) Mbas dëmtimit të madh që krijoi iluzioni "shëndetësi falas", duhet të flasim me realizëm për financimin e sistemit. Sistemi shëndetësor kushton shumë, kudo ku ai është i zhvilluar. Prandaj duhet të rriten ndjeshëm financimet për këtë, mundësitë janë. Së pari, duhen konvertuar pagesat direkte të popullsisë (ato nga xhepi i secilit për ilaçet, shërbimet, pagesat e ndryshme, stomatologun etj., etj.) që arrijnë në rreth 135 euro për frymë në vit, në kontribute direkte (siguracione) të përdorshme nga individët e zhvilluese për sistemin dhe që sot janë shumë të ulëta. Këto i japin soliditet e autonomi financimit të shëndetësisë. Pa asnjë dyshim kontributi i buxhetit duhet të kalojë nga 1,95 % në minimalisht 3,5% të GDP. Po kështu, duhen ndërprerë të gjitha shpenzimet abuzive ose pa rentabilitetin e nevojshëm, që sot kapin rreth 350 M Euro në 10 vit në formën e koncesioneve. Me dy fjalë, unë këmbëngul që është e domosdoshme ngritja i një sistemi financimi miks, të bazuar në një sistem sigurativ të diversifikuar e konkurrues. Kjo kërkon që sa më shpejt të largohemi edhe nga koncepti monopolizues e jo stimulues tashmë, nga ai i një "blerësi të vetëm të shërbimit", për të hapur kështu tregun e sistemeve sigurative, publike e private, konkurrencën.

b) Decentralizimi i spitaleve për të shkuar te "spitali ndërmarrje" është imperativ. Kjo kërkon largim nga konceptet arkaike centraliste si "spitale bashkiake e rajonale", financim të tyre në bazë të DRG për shërbimin që ofrojnë, konkurrencë e "treg shëndeti" real. c) Kujdesi parësor duhet t'i nënshtrohet jo vetëm decentralizimit, por duhet të ecë drejt bazimit të tij mbi "profesionistin e lirë", mjek familje a specialist ky, i paguar nga sistemi sigurativ për shërbim. d)Një hapësirë tjetër e

➔

Një nga protestat e opozitës

madhe dhe e pashfrytëzuar është privati në shëndetësi. Ai duhet të konsiderohet si pjesë integrale e sistemit, ku pacienti mund të shkojë lirshëm i paguar tërësisht nga sistemi sigurativ, apo fillimisht mbi bazën e bashkë pagesës, që duhet pranuar qartësisht si alternativë. Trajtimi si një shtojcë e sektorit privat është një miopi e madhe. e) Për të realizuar këto është e domosdoshme të mbizotërojë koncepti thelbësor stimulues - pacienti është i lirë të zgjedhë ai vetë spitalin që dëshiron, mjekun e familjes apo specialistin ambulator. Në fakt, kjo është një e drejtë universale e njeriut në demokraci. Ai jo vetëm zgjedh, por merr me vete në këtë zgjedhje dhe financimin nga sektori sigurativ, që e derdh aty ku ai shkon. Kjo do të plotësonte kushtin themeltar të krijimit të konkurrencës pozitive, "tregut të shëndetit" etj., si bazë e zhvillimit, rritjes së cilësisë së shërbimit e uljes së kostos. Fatkeqësisht në të gjitha programet e qeverisë dominon ideja e bllokimit, e "getozimit" të popullsisë, pra e kundërta e këtij principi progresiv. f) Më tej janë shumë elementë të tjerë, që duhen ndryshuar. Psh., farmaceutika duhet të zgjidhë problemet gamës së pamjaftueshme, të sigurisë e cilësisë së dyshimtë të medikamenteve e materialeve në vend, që sot janë një problem madhor. Së dyti, rritja disa herë e fuqisë rimbursuese në numër medikamentesh e përqindje vlere në tregun e hapur në dobi të qytetarëve, është një domosdoshmëri, etj. Po kështu, duhen zgjeruar procedurat e mbështetura nga skemat siguartive si psh., për stomatologjinë, fizioterapinë, mbulesat sociale në përgjithësi etj. h) Ndërsa rritja e numrit të mjekëve e specialistëve është një proces që kërkon një strategji të gjerë e afat gjatë. Ka ardhur koha për aktivizimin e së paku edhe të dy fakulteteve të tjera publike të mjekësisë. Po kështu, duhet zgjeruar baza mësimore klinike për specializimet me qendra të tjera spitalore publike a private, jo vetëm në Tiranë këto, për të shtuar kështu ndjeshëm numrin e specialistëve, duke filluar që nga mjeku i familjes. E rëndësishme është që shoqëria e shteti të kuptojnë që mjekët nuk kanë nevojë vetëm për paga më të mira, por edhe për kushte të përshtatshme pune, zhvillim të vazhdueshëm teknik e profesional, aktivitet shkencor e mbi të gjitha respekt e dinjitet, që sot është nëpërkëmbur me keqdashje, pikërisht për t'i anatemuar ata në raport me nivelin katastrofal të sistemit. Ka ardhur koha për të vendosur një raport të ri stimulues e të emancipuar midis shtetit e mjekëve, apo edhe specialistëve në tërësi.

Besoni se janë të realizueshme të gjitha këto që përmendët?

Jam optimist se kam besim te ndryshimet e mëdha në Shqipëri. Do të isha pesimist nëse nuk do të mendoja kështu. Kam besim pikërisht se ndërgjegjësimi i njerëzve për atë se ku po shkon vendi, jo vetëm shëndetësia, te reaksioni i qytetarëve për të ndaluar të keqen që po rritet e orientuar përpjekjet e përbashkëta drejt alternativave të tjera pozitive. Pa dyshim, sistemi shëndetësor shqiptar nuk mund të hyjë në rrugën e normalitetit në qoftë se e gjithë Shqipëria nuk futet në këtë rrugë. Dhe për këtë duhen ndryshimet e mëdha politike në vend, që të sjellin vizione të ditura, pasione të guximshme, përgjegjësi e korrektësi qytetare në krye të shoqërisë sonë.

Prandaj Partia Demokratike po shkon drejt protestave?

Absolutisht po, në një sens. Por unë do të thosha se nuk është vetëm PD në protestë, është Shqipëria në protestë. Dhe kjo si pasojë e gjendjes së vështirë e në përkeqësim të vendit. Ne folëm për shëndetësinë më lart, por ashtu janë dhe sektorët e tjerë të vendit. Është niveli ekonomik, financiar, varfëria e thellë, papunësia e lartë etj., etj., që po e çojnë vendin në shpërthim. Nga ana tjetër, situata është përkeqësuar së tepërmi përballë korrupsionit masiv e infiltrimit të azilit që ka marrë përmasat e një eksodi masiv së fundmi, i dëshirueshëm ky për qeverisjen, por jo për Shqipërinë. Prandaj, ky shpirt proteste tani duhet të orientohet në kanalet e një lëvizjeje të madhe demokratike popullore, produktive, e cila vetëm kështu do të japë efektet thellësisht pozitive e ndryshuese të gjithanshme të domosdoshme për vendin. Vetëm kështu mund të evitohet rreziku real, që kjo protestë të shpërthejë spontanisht dhe në mënyrë kaotike, me shumë dëme të paparashikuara. Ndërkaq, unë e kuptoj që sfidat e kësaj lëvizjeje janë të shumta. Por së pari duhet të luftohet që të marrë fund dominimi i krimit kudo. Ju vetë e patë çfarë ndodhi e po ndodh me drogën. PD-ja pa dyshim si forca kryesore opozitare e ka për detyrë e mision ta udhëheqë, ta drejtojë këtë protestë të madhe popullore, që po ndjehet kudo. Dhe kjo është në të mirën e vendit, njerëzve, stabilitetit. Ndryshe gjërat mund të shkojnë në mënyrë kaotike e shkatërruese. Në të vërtetë kjo protestë masive tashmë e filluar në çdo shtëpi, familje, ambient shoqëror, në forma nga më të ndryshme, shpesh jo të qarta apo të dobishme, siç është fenomeni i

SFIDA

"Duhet të luftohet që të marrë fund dominimi i krimit, drogës, arbitraritetit etj., që kanë prekur të gjithë sektorët e jetës. Janë këto të këqija, që më tej shtyjnë edhe drejt shkeljeve kushtetuese, deformimit të demokracisë, ligjit, shkatërrojnë ekonominë etj.", theksoi z.Shehu.

Kreu i PD: S'ka për të pasur reformë në drejtësi me Ramën kryeministër

Basha: Kryengritje popullore deri në çmontimin e qeverisë së krimit

Kreu i PD-së, Lulzim Basha nga Lushnja shprehu bindjen se largimi i Edi Ramës do t'i hapë rrugë një qeverie antimafie, sipas tij e aftë për të zbatuar reformën në drejtësi, që nuk mbron, por ndëshkon kriminelët e veshur me pushtet dhe ministrat e korruptuar. Z.Basha e vazhdoi në Lushnjë turin me të cilin po i paraprin protestës së 27 janarit. Ai tregoi disa statistika se si kriza ekonomike, siç tha ai, po ndihet në çdo familje. Po ashtu etiketoi Lushnjën si qytetin ku bandat përcaktojnë kush punon apo dhe kush merr tenderë. "247 biznese të mbyllura javën e parë të janarit. 13 mijë të mbyllura gjatë vitit të kaluar, po të heqësh të shtunat e të dielat, i bie që janë mbyllur 50 biznese në javë. Edi Rama u ka shpallur luftë njerëzve të thjeshtë të këtij vendi. Rinia është në dëshpërim dhe 70% e atyre që largohen janë të moshës 19 deri në 35 vjeç. Fermerët shqiptarë asnjë kacidhe nuk kanë parë dhe asnjë mbështetje nga shteti", - u shpreh Basha. Ai vuri në dukje se pakti i Edi Ramës me krimin po shkatërron reformën në drejtësi për të mbrojtur pushtetin e vet, të cilin e bleu me paratë e drogës së Saimir Tahirit, Vangjush Dakos, Qazim Sejdinit dhe të korrupsionit të ministrave të tij Arben Ahmetaj, Damian Gjiknuri, Ilir Beqja etj. Kryetari i Partisë Demokratike vuri në dukje se edhe emëri-

TAKIMI

Lideri i PD-së, Basha dhe ajo e LSI, Kryemadhi kanë shtuar daljet publike së bashku për të konfirmuar bashkëpunimin e ngushtë mes dy partive opozitare. Ata janë parë së bashku në një kafe miqësore në kafenenë e një hoteli në Tiranë. Prezentë ishin bashkëpunëtorët e afërt, Manjani nga LSI dhe Gjana nga PD si dhe kreu i PR, Fatmir Mediu.

mi i Prokurorit të Përgjithshëm pa veting dhe kundër Kushtetutës është pjesë e projektit të Edi Ramës për kontrollin politik të drejtësisë dhe mbylljen e dosjeve të krimit dhe korrupsionit qeveritar. "Nuk ka për të pasur reformë në drejtësi me Edi Ramën kryeministër, ndaj protesta e 27 janarit është edhe një thirrje për reformën në drejtësi, për drejtësinë e pakapur. Është një thirrje dhe një bashkim që Saimir Tahiri të shkojë në burg, siç duhet të shkojë në burg çdo ministër, çdo pushtetar vendor apo qendror i faktuar në lidhje me krimin e organizuar dhe i korruptuar deri në palcë me paratë dhe asetet e shqiptarëve", - theksoi Basha. Kreu i opozitës bëri të qartë se 27 janari është dita e një rrugëtimi, që nis me një goditje të fuqishme dhe do të vazhdojë me të gjitha format e kryengritjes popullore deri në çmontimin e qeverisë dhe aleancës me krimin, të kryesuar nga Edi Rama, i cili po e mban larg Shqipërinë nga Europa. "Pjesëmarrja masive në protestën e 27 janarit është sinjali më i qartë, treguesi më i drejtpërdrejt për çdo shqiptar, për zullumqarët dhe për miqtë e Shqipërisë, se ora e Edi Ramës në Shqipëri ka marrë fund. Se një orë e re ka nisur të trokasë. Dhe se ky vend dhe qytetarët e këtij vendi nuk e pranojnë më aleancën me krimin dhe janë të vendosur t'i shkojnë deri në fund betejës për Shqipërinë europiane", - tha Basha. Kreu i PD përmendi se largimi i Edi Ramës do t'i hapë rrugë një qeverie antimafia, e aftë për të zbatuar reformën në drejtësi, që nuk mbron, por ndëshkon kriminelët e veshur me pushtet dhe ministrat e korruptuar.

krimit, drogës, arbitraritetit etj., që kanë prekur të gjithë sektorët e jetës. Janë këto të këqija që më tej shtyjnë edhe drejt shkeljeve kushtetuese, deformimit të demokracisë, ligjit, shkatërrojnë ekonominë etj. Sot kërkohet një ballafaqim i fuqishëm e demokratik me këto rreziqe, që t'i hapet rrugë progresit. Kush tjetër përveç PD-së mund të jetë në ballë të një lëvizjeje të tillë popullore? Askush tjetër. Pra, tashmë kjo është një detyrë imperative e PD-së, ndryshe gjërat do të përkeqësohen në mënyra të paparashikueshme e të pandreqshme.

Cilat janë pritshmëritë tuaja, a do t'ju ndjekin shqiptarët, a do t'ju besojnë?

Unë mendoj se po. Mjafton që ne të dimë të orientohemi drejt, të shpjegojmë qartë idetë tona, atë që propozojmë për të ardhmen etj. Pra, ne duhet të jemi kritikë ndaj realitetit të errët që mbizotëron, por edhe alternativë, të qartë e konkretë për të ardhmen. Dhe besoj se ne i kemi kapacitetet njerëzore, politike, profesionale, të drejtën morale për ta bërë këtë gjë. Veprimtaritë që kemi filluar duhen zgjeruar, kontaktet duhen shumëfishuar, duhen shfrytëzuar të gjitha mundësitë direkte, mediatike grupesh, ambientesh të ndryshme, gjithçka. Diçka duhet të kuptojmë, gjërat nuk zgjidhen me një "deus ex machina". Ky është një proces demokratik, ku çdo element ka rëndësinë e tij e duhet shfrytëzuar me kujdes. Në këtë hapësirë, protestat kanë një rëndësi të madhe, veçanërisht për gjendjen aktuale, ku edhe kur qeverisja po përpiqet veçse të terrorizojë njerëzit me mjete e shkaqe nga më të ndryshme. Përpiqet ta bëjë këtë me çështjet më personale e familjare e deri te puna, me varfërinë, hallet me drogën e kultivuar e të fshehur, me presion psikologjik direkt, mediatik etj. Dhe këtu protesta merr një rëndësi të madhe. Vetëm të qënit në protestë në grupe të mëdha të jep guxim, largon ndrojtjen e frikën e deri te mesazhi i forcës e ndryshimit që transmeton. Këto janë të domosdoshme për ndryshimet e kërkuara nga të gjithë, veçanërisht kjo për realitetin e shoqërisë sonë. Pra, larmishmëria e aktiviteteve është shumë e rëndësishme, midis të cilave forcimi i tonit e dimensioneve të protestave në këto situata është thelbësore. Pikërisht këto janë objektivat e punës dhe impenjimit të PD-së tashmë.

Në këtë betejë jeni bashkë me LSI-në, si influencon kjo?

Në këtë këtë betejë jemi së bashku me gjithkënd që është i vendosur t'i kundërvihet kësaj situate të rëndë në vend, me të gjithë ata që duan të bëjnë opozitë reale. Në opozitë nuk ka zakonisht koalicione (ai i tillë që kemi është ai parazgjedhori). Të tjerat janë bashkëpunime të gjera për çështjet ku përputhen idetë, alternativat, interesat. Pa dyshim LSI-ja edhe për vetë dimensionet parlamentare të saj është nga më të rëndësishmet në këtë bashkëpunim të gjerë dhe kjo është krejt normale dhe e dobishme. Vendi ka nevojë për bashkim të të gjithë forcave politike, por jo vetëm edhe të grupimeve, individëve etj., që duan të pengojnë varfërinë, arbitraritetin, shkeljet e ligjit, të Kushtetutës, kolapsin ku po shkon ky vend, për të gjithë ata që aspirojnë në parimet e zhvillimit, demokracisë, Perëndimit e integrimit europian.

Nisin procedurat për kompensimin financiar të pasurive që preken nga ndërtimet informale

ATP publikon listën me 470 pronarë që marrin 300 milionë lekë

Formulari TIP dhe afati për dorëzimin e 6 dokumenteve

Ornela Manjani

Publikohet lista me emrat e 470 pronarëve që marrin kompensimin për tokën e zënë nga ndërtimet pa leje. Vlera në total e kompensimit arrin në afro 300 milionë lekë. "ATP njofton fillin e procesit të pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve janë sipas VKM Nr.810, datë 29. 12. 2017. "Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën 18/01/2018 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë. ATP fton të gjithë subjektet e interesuara, të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të premte, për plotësimin e kërkesës për kompensim dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse"- thuhet në njoftimin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Sipas vendimit mësohet se kjo do te bëhet për qarqet: Dibër, Durrës, Elbasan, Tiranë, Korçë Fier, Vlorë dhe Shkodrës.

KOMPENSIMI

Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas ZVRPP-ve, është 20 787,98 m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 298 515 448,9 lekë.

PRANIMI I KËRKESAVE

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura. Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës, nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

DOKUMENTET

1- Kërkesën për kompensimin e pronës, sipas formatit tip, që i vihet në dispozicion nga ATP;

2- Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil;

3- Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. (Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo kërkesë të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 (dymijë) lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme);

4- Vërtetimin origjinal të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;

5- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit;

6- Mandat pagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 000 lekë. Subjektet përfituese, kërkesa e të cilëve nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme, kanë të drejtë të riaplikojnë. Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojnë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm.



DOKUMENTET

Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesën tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial duhet të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjithë subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronarë apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

FORMULAR APLIKIMI

KOMPENSIM FINANCIAR PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE INFORMALE

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@atp.gov.al
Web: www.atp.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

Shënim Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri
2. Mbiemri
3. Emri i Babait
4. NID
5. Gjinia — Mashkull — Femër
6. Datëlindja
7. Vendlindja
8. Shtetësia
9. Adresa
10. Qyteti
11. Rrethi
12. Kodi Postar
13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular
15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Subjekti përfitues

Emri — Emri i Babait
Mbiemri

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
MURAT	MAHMUT	QAFLESHI					
ABDULLAH		QAFLESHI					
AZMI		QAFLESHI	2/235	279,4	12.764	3.566.261,60	
NIAZI	YMER	HOXHA	12/237	27,8	12.764	354.839,20	
BAJRAM	MEDI	TERA					
DIK		TUSHA					
SULEJMAN	VELI	FACI					
KADRI		TUSHA	109/14	500	284	142.000	
DALIP	KADRI	BAKALLI					
DRITAN	SADIK	CENGELI					
FATUSH		BAKALLI					
NASHIFER		BAKALLI					
MELEQ		BAKALLI					
KADESHE		BAKALLI					
MUSA		BAKALLI					

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
SHEJNAZ		BAKALLI					
BURBUQE		BAKALLI	1372/7	183,40	12.764	2.340.917,60	
				361,70		4.616.738,80	
				152,20		1.942.680,80	
				287,60		3.670.926,40	
				302,80		3.864.939,20	
				111,70		1.425.738,80	
				331,40		4.229.989,60	
MERJEME	ADEM	HUTA	1415/99	127,91	12.764	1.632.643,24	
HASAN		BEBETI	1415/5	173,05	12.764	2.208.810,20	
FLORA	XHAFERR	HASEKIU(UCI)					
FISNIK	XHAFERR	HASEKIU					
ENGJELL	XHAFERR	HASEKIU					
FEIME	SKENDER	HASEQIU					
MARSELA	BARDHUL	HASEQIU	1415/258	225,90	12.764	2.883.387,60	

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
DORINA	BARDHUL	HASEQIU					
KRESHNIK	FRANK	UCAJ					
DALIP	ZENEL	KUQJA					
HYSEN	DALIP	KUQJA					
ZENEL	DALIP	KUQJA					
FAHRI	JONUZ	LAMÇJA					
DIJE	JONUZ	LAMÇJA					
ISMAIL	JONUZ	KAMAMI	6/82	130,60	259	33.825,40	
AGIM		ARAPI					
NDRIÇIM		ARAPI					
SHPETIM		ARAPI					
HAJRIE		ARAPI					
SULEJMAN		ARAPI	16/611	115,2	12.764	1.470.412,80	
ENVER	QAMIL	PACARA	16/69	22,53	5.280	118.958,40	
KLJUTIM	QAMIL	PACARA					
-	-	-	-	-	-	-	-
GJON	KOL	NDREU	191/39	383,00	228	87.324,00	E lire
PRENA	GJERGJ	DEDA					
NDUE	GJERGJ	DEDA					
ZEF	GJERGJ	DEDA					
LEK	GJERGJ	DEDA					
PASHKE	GJERGJ	DEDA					
AGE	GJERGJ	DEDA					
LULE	GJERGJ	DEDA	359/339	132,00	337	44.484,00	E LIRE
PRENA	GJERGJ	DEDA					
NDUE	GJERGJ	DEDA					
ZEF	GJERGJ	DEDA					
LEK	GJERGJ	DEDA					
PASHKE	GJERGJ	DEDA					
AGE	GJERGJ	DEDA					
LULE	GJERGJ	DEDA	359/311	184,70	337	62.243,90	E LIRE
MBIVENDOSJE			1/228	118,00	8.511	1.004.298,00	MBIVENDOSJE, VIJON EDHE NGA VOL.10 FAQ:68
ASLLAN		MLIKA					
MUHO		MLIKA					
ESAT		MLIKA					
ZENEL		MLIKA					
QAMIL		MLIKA					TRUALLI I PRONESISE SE PAS.1/239 PERFSHIN EDHE PAS. 1/238 E CILA ESHTE E KLIRUAR PER SHKAK TE MBIVENDOSJES.
SHYQYRI		MLIKA	1/229	69,00	8.511	587.259,00	
ARBEN		LIKA					
BARDHYL		LIKA					
BRILANDA		LIKA					
FATBARDHA		LIKA					
LEJLA		LIKA	2/546	15,60	12.223	190.678,80	MUNGON REFERENCA FIZIKE:00005002 NE ARKIVE.
THEODOR		LASHOVA					
OLLGA		LASHOVA					
MIHAIL		LASHOVA	4/687	19,40	12.223	237.126,20	
ILIR	SAMI	PILACA	7/302	11,60	12.223	141.786,80	
VAHID		BORIÇI					Seksioni D: Mbi kete truall ndodhet ndertes me nr. Pas 2/722, Mbi kete truall ndodhet pasuria nr.pas 2/721 Nt. vl 36, fa 47, Seksioni E: Mbi
TAHSIM		BORIÇI	2/720	33,07	12.223	404.214,61	
KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR			1/640	243,40	32.878	8.002.505,20	
DAUT	QAMIL	FORTUZI	3/440	126,30	34.068	4.302.788,40	
ARJET		KULA	9/176	7,80	31.270	243.906,00	
MEHMET		ILJAZI					
SULEJMAN		ILJAZI	1/379	298,00	32.878	9.797.644,00	
FATMIR		BEZHANI	315/194	265,80	4.242	1.127.523,60	
				353,50	4.242	1.499.547,00	
AISHE	QAZIM	KERCANI					
FERIT	QAZIM	KERCANI					
HYSNI	QAZIM	KERCANI					
LUMTURI	QAZIM	KERCANI					
QEFSERE	QAZIM	KERCANI					
SHABAN	QAZIM	KERCANI	8/278	151,70	31.270	4.743.659,00	
AISHE		TORA					Nr.Dok.9613 dt.25/09/2013 , Ne favor te NIKO KOMPANY ; Nr.Dok.9242 dt.25/09/2013 , Ne favor te SIQECA SQ.SHPK , Nr.Dok.10177 dt.11/07/2014 , rregjistrohet kerkese padia
FERID		KERCANI					
HYSNI		KERCANI					
LUMTURI		MUCA					
QEFSERE		AGO					

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
SHABAN		KERCANI	8/355	133,10	31.270	4.162.037,00	
EDMOND	MYHEDIN	HALI	4/718	7,60	31.270	237.652,00	
ENDRIT	AGIM	BEQAJ	4/203	7,50	31.270	234.525,00	
REFAT	KAMBER	QEBINAJ	7/404	13,10	29.106	381.288,60	
HAJDAR		SHABANI	7/501	1,10	29.106	32.016,60	
BASHKIM	BEG	SHABANI					
DRITA	BEG	SHABANI					
FATIME	HAJDAR	SHABANI					
HASAN	HAJDAR	SHABANI					
LULJETA	BEG	SHABANI					
NURI	HAJDAR	SHABANI					
RAMAZAN	BEG	SHABANI					
SHAJE	RAMAZAN	SHABANI					
SHAQIR	HAJDAR	SHABANI					
SHEFQET	BEG	SHABANI					
SKENDER	BEG	SHABANI	7/254	1,70	29.106	49.480,20	
KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			8/254	**79,00**	32.878	**2.597.362,00**	
XHUVANE		SHKRETA					
HAJNE		PICARI					
SADETE		VESHI					
SHPRESA		SHKRETA					
FLORIAN		SHKRETA					
MEREME		SHKRETA					
FATMIR		GJEDIKU					
OSMAN		SHKRETA					
DYLBERE		SHKRETA					
RIHAN		SHKRETA					
ALKED		SHKRETA					
ARBEN		SHKRETA					
SAIMIR		SHKRETA					
FLORIDA		SHKRETA					
MARJETA		SHKRETA					
YLLI		SHKRETA					
PELLUMB		SHKRETA					
YMER		SHKRETA					
XHEMILE		SHKRETA					
VJOLLCA		SHKRETA					
LUAN		SHKRETA					
MAJLINDA		SHKRETA					
GJYLE		SHKRETA	13/230	**263,70**	32.878	**8.669.928,60**	
ARBEN	RAMIZ	LULI					
ENGJELLUSHE	RAMIZ	LULI					
FLORA	MUSTAFA	SALIKU					
HAXHIRE	ISLAM	LULI					NDALON VEPRIMET MBI PASURITE ME AFAT DERI NE ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TE KRIJUAR NGA REGJISTRIMI I PARREGULLT NE SISTEMIN HIPOTEKOR
PETRIT	MUSTAFA	LULI					
SELIM	RAMIZ	LULI					
VJOLLSA	MUSTAFA	SALIKU	11/18	**269,30**	32.878	**8.854.045,40**	
QAMILE	HAXHI	BEGA					
SHPRESA	BEDRI	KONI (BEGA)					
ETHEM	BEDRI	BEGA					
MERITA	BEDRI	MERJA (BEGA)					
MEJTE	BEDRI	BRARI (BEGA)					
NAIME	SHABAN	BEGA	13/245	**13,60**	32.878	**447.140,80**	
BASHKIM	HAMIT	BEGA					
SADETE	HAMIT	TUJANI(BEGA)					
ILIR	HAMIT	BEGA					
MAKBULE	HAMIT	XHAJA (BEGA)					
MYSLIM	BEDRI	BEGA					
AHMET	OSMAN	XIBRI					
DYLBERE	OSMAN	DELISINA					
KLJUTIM	OSMAN	XIBRI					
RUKIE	OSMAN	SHKODRA					
SELMAN	OSMAN	XIBRI	8/222	**102,40**	32.878	**3.366.707,20**	
AGIM	HYSEN	MUMAJESI					
AISHE	HYSEN	MUMAJESI					
ALTIN	ABDYL	HYKA					
ARBEN	XHEMAL	MUMAJESI					
ASTRIM	MUHARREM	KAMI					
BAJRAM	REXHEP	TAFAJ					
BESNIK	XHEMAL	MUMAJESI					
DHURATA	SHERQET	DEHEMI					
DJANA	BAJRAM	TAFAJ					
ENVER	XHEMAL	MUMAJESI					

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
FATBARDHA	XHEMAL	MUMAJESI					
FATMIR	HYSEN	MUMAJESI					
FLUTURA	SHEFQET	KRUETANI					
GUGASH	SHEFQET	HOXHA					
HATIXHE	MURAT	KAIMI					
HAVA	HAXHI	DUXHA	9/327	303,50	31.270	9.490.445,00	
BUJAR		DAJA					
FATMIRA		MULLALIU					
ILIRJANA		HUTA (HIDAJ)					
MINIR		DAJA					
MIT'HAT		HIDAJ					
SADIK		HIDAJ					
YLLKA		KONCI					
ZAMIRA		MARKU					
FATIME		ASLLANI	8/383	12,70	31.270	397.129,00	URDHER REGJISTRIM KUFIZIM TE DHENASH
KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			5/150	246,40	31.270	7.704.928,00	
ISUF	XHEMAL	MUMAJESI					
JETMIRA	MUHARREM	HAKA					
LUAN	XHEMAL	MUMAJESI					
MAJLINDA	XHEMAL	MUMAJESI					
MEREM	SHAQIR	HYKA					
NIMETE	OSMAN	CELA					
PELLUMB	XHEMAL	MUMAJESI					
PETRIT	XHEMAL	MUMAJESI					
REXHEP	MUHARREM	KAIMI					
SABRIJE	OSMAN	PICARI					
SHQIPONJA	SHEFQET	DINO					
SILVANA	MUHARREM	SHIMA					
SULEJMAN	ABDYL	HYKA					
VERA	SHEFQET	VAKIARI					
YLLI	BAJRAM	TAFAJ					
KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			9/613	437,20	31.270	13.671.244,00	
KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			9/613	427,00	31.270	13.352.290,00	
VANGJEL	KALAM	JANAQI					
ALEKSANDRA	JANI	BOJANI(JANAQI)					
DHIMITRAQ	JANI	JANAQI					
NAUM	JANI	JANAQI					
LULJETA	RAMAZAN	JANAQI					
JANI	VASIL	JANAQI					
ENEA	VASIL	JANAQI					
MARJANA	JANI	MATA(JANAQI)					
LIRIKA	JANI	JANAQI					
ANTONETA	JANI	CELA(JANAQI)	8/8	21,20	66.969	1.419.742,80	
VANGJEL	KALAM	JANAQI					
ALEKSANDRA	JANI	BOJANI(JANAQI)					
GJERGJ	JANI	JANAQI					
NAUM	JANI	JANAQI					
LULJETA	RAMAZAN	JANAQI					
JANI	VASIL	JANAQI					
ENEA	VASIL	JANAQI					
MARJANA	JANI	MATA(JANAQI)					
ANTONETA	JANI	CELA(JANAQI)					
LIRIKA	JANI	JANAQI	8/8	19,60	66.969	1.312.592,40	

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
ABDURAHMAN		GJAKOVA	8/398	13,50	66.969	904.081,50	
AGIM	BAJRAM	XHEPA	85/5	97,60	2.560	249.856,00	
TOMOR		BETA	85/103	142,40	2.560	364.544,00	
ABDULLA		XHAMETA	425/57	377,50	2.560	966.400,00	LIROHET PRONA VENDIM 2540
SHQIPONJA	AGRON	KUSI					
DANJELA	DURIM	KUSI					
GEZIM	DURIM	KUSI	433/108	214,40	2.560	548.864,00	
SHQIPONJA	AGRON	KUSI					
DANJELA	DURIM	KUSI					
GEZIM	DURIM	KUSI					
KEJSI	DURIM	KUSI	433/158	197,60	2.560	505.856,00	
SAMI	XHELAL	HOXHA	312/50	482,70	4.242	2.047.613,40	
ALEKS	DALIP	MALAJ	312/19	186,90	4.242	792.829,80	
SAMI	XHELAL	HOXHA	308/9	267,00	4.242	1.132.614,00	
KASEM	MERSIN	BRAHJA	14/17	354,00	3.283	1.162.182,00	
DAKLEA	ALFRED	XINXO	14/18	102,20	3.283	335.522,60	NE FAVOR TE BANKES GREKE
KASEM	MERSIN	BRAHJA	14/17	226,80	3.283	744.584,40	
KASEM	MERSIN	BRAHJA	14/17	354,00	3.283	1.162.182,00	
KRYEGJYSHATA	BOTERORE	BEKTASHIANE	6/226	101,60	31.270	3.177.032,00	
KRYEGJYSHATA	BOTERORE	BEKTASHIANE	5/222	73,10	31.270	2.285.837,00	
EDUART	ENVER	DUSHKU	24/5	397,90	2.560	1.018.624,00	
AGIM		DINE	1/161	276,60	23.703	6.556.249,80	
BUKURIJE		ALIMEHMETI					

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
FIQIRI		KASHARI	170/56	120,20	479	57.575,80	
BAJRAM	HAMIT	XHAMETA					
BEDRI	LATIF	XHAMETA					
BLEDAR	LATIF	XHAMETA					
BUJAR	LATIF	XHAMETA					
ENVER	LATIF	XHAMETA					
FATOS	LATIF	XHAMETA					
GANI	HAMIT	XHAMETA					
HASAN	QERIM	XHAMETA					
ILIIR	LATIF	XHAMETA					
KADRI	HAMIT	XHAMETA	2/446	182,80	23.703	4.332.908,40	
ROBERT	KITO	XAMO	4/172	1,30	23.703	30.813,90	
JASHAR SHABAN	MUSTAFA	XHAMETA	1/860	25,10	23.703	594.945,30	
LULZIM	ABEDIN	GOJKA	6/424	1,30	23.703	30.813,90	
JASHAR	MUSTAFA	XHAMETA	5/330	66,20	23.703	1.569.138,60	
JASHAR	MUSTAFA	XHAMETA	1/861	96,70	23.703	2.292.080,10	
JASHAR	MUSTAFA	XHAMETA					
SHABAN	MUSTAFA	XHAMETA	1/861	96,70	23.703	2.292.080,10	
RESHAT	HAKI	ZIKA					
YLLI	MUHARREM	FERHATI	2/1044	277,00	23.703	6.565.731,00	
AGRON		BOGDANI					
ATLIJE		YLLI					
BILAL		BOGDANI					
DIANA		BIBA					
EMINE		BOGDANI	7/925	2,40	30.783	73.879,20	
FATMIR		BOGDANI					
RAMAZAN		BOGDANI					
RESHAT		BOGDANI					
SAIMIR		BIBA					
AGRON		BOGDANI					
ATLIJE		YLLI					
BILAL		BOGDANI					
DIANA		BIBA					
EMINE		BOGDANI					
FATMIR		BOGDANI					
RAMAZAN		BOGDANI					
RESHAT		BOGDANI					
SAIMIR		BIBA	7/250	64,60	30.783	1.988.581,80	KUJDES MBIVENDOSJE PER SIP = 8.9 M2 DERI NE ARDHJEN E VKM SE SHPRONESIMIT
AGRON		SALLMONE					
AHMET		KRUJA					
ANDREA		SALLMONE					
ARJAN		SALLMONE					
AURELA		KRUJA					
BASHKIM		KRUJA					
ELTON		KRUJA					
GANI		SALLMONE					
MAJLINDA		SALLMONE					
MIMOZA		SALLMONE					
RIGELS		KRUJA					
XHEMAL		KRUJA					
BUKURIJE		KRUJA	2/35	287,00	30.783	8.834.721,00	
BUJAR		DAJA					
DYLBERE		KELLICI					
FATMIRA		MULLALIU					
MINIR		DAJA					
YLLKA		DAJA					
ZAMIRA		MARKU	8/785	228,40	31.270	7.142.068,00	
AISHE		PULLEJA	11/307	24,80	31.270	775.496,00	
AISHE		PULLEJA	11/137	51,40		1.607.278,00	URDHER KUFIZIM
LILIANA		HUTA	8/276	9,30	31.270	290.811,00	
LINDITA	SKENDER	PEZA(HUTA)					
HALIL	HAMZA	HYSENAJ	8/722	193,80		6.060.126,00	
LULJETA	REXHEP	KERCANI					
NURI	REXHEP	KERCANI					
SHPRESA	REXHEP	KERCANI	3/112	353,00		11.915.515,00	
LULJETA	REXHEP	KERCANI					
NURI	REXHEP	KERCANI					
SHPRESA	REXHEP	KERCANI	3/316	17,20	33.755	580.586,00	
MIHILL	NIK	RAMAJ	8/447	218,30		7.368.716,50	INSK.779 DT22.02.2011
PELLUMB	RAMADAN	DOREZI	8/1028	26,70		901.258,50	
VALENTINA	NESHAT	SELIMI					
JONIADA	LUAN	SELIMI					
ROMINA	LUAN	SELIMI					
NESHAT	HODO	LILO	8/980	19,00	33.755	641.345,00	
SELIM	HAJREDIN	KUNIQI	2/502	286,90	33.755	9.684.309,50	
LULJETA		KERCANI					
NURI		KERCANI					
SHPRESA		KERCANI	3/880	189,20	33.755	6.386.446,00	
SADIK	VESEL	LURA	14/288	49,60		1.674.248,00	
MEDIHA		CELA	14/291	5,20		175.526,00	
HYSEN	LATIF	BASHA	14/286	43,00	33.755	1.451.465,00	
AIDA		FRASHER(BESHO)					
ARDIAN		TOPTANI					
BEHIJE		ALDA(TOPTANI)					
FADIL		TOPTANI					
MELEQ		FRASHERI					
MYNYRE		TOPTANI					
NADIA		FRASHERI					

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Viera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
NIRVANA		LEKAJ(FRASHERI)					BLLOKOHET NE FAVOR TE UNION BANK PER SHUMEN 5000000LEK
XHEMILE		TOPTANI	7/667	269,50	33.755	9.096.972,50	
AGIM	RAGIP	BEJA					NDALIM VEPRIMESH PER MUNGESE DOKUMENTACIONI
HAMIDE		BEQO(BEJA)					
NAIME		ALIKO(BEJA)	2/5	51,00	33.755	1.721.505,00	
LIZA		MATI(ARYA) IRMA	9/18	311,00	33.755	10.497.805,00	
LILJANA		PACI	51/161	245,70	3.413	838.574,10	
JONUZ	JAKUP	AJVAZI	295/7/3	116,80	528	61.670,40	
ABDI		CIBAKU	295/7/11	185,40		97.891,20	
PETRO	MUHARREM	DUSHKU	300/94	26,90		14.203,20	
DRITAN	MUHARREM	DUSHKU	300/93	210,20		110.985,60	
VASFI	MUHARREM	DUSHKU	300/92	62,90	528	33.211,20	
RUZHDI		SHURDHI	224/14	248,50	4.242	1.054.137,00	
MALIQ	ISUF	LULI	65/98	204,60	479	98.003,40	
MUSTAFA		LULI	224/15	219,70	479	105.236,30	
RAMIZ	SELIM	LULI					
MUSTAFA		LULI	224/15	149,20	479	71.466,80	
RAMIZ	SELIM	LULI					
MALIQ	KASEM	SPAJA	129/3	247,30	479	118.456,70	
YLLI	ZALO	CACI	159/40	228,00	500	114.000,00	
MEXHIT	QAMIL	ALLMETA	334/1/4	324,41	3.560	1.154.882,87	Mbi keto pasuri ndodhet ndertesa me nr.334/1/4-ND ,Vol 10, Fq 15
QAMIL	ASLLAN						
ARGJEND	HAMIT	ALLMETA	334/4	132,15	3.560,00	470.454,00	
LUAN	XHELADIN	SHALA		10,50			
ETLEVA	ASLLAN	SHALA		5,25			
ERISA	LUAN	SHALA		5,25			
BISLIM	LUAN	SHALA		5,25			
SABRIJE	LUAN	SHALA		5,25			
ELJAN	LUAN	SHALA	27/23	5,25	2.560	94.080,00	
HANIFE		LISAKU	27/64	87,00	2.560	222.720,00	
MUSTAFA	AVDULLA	GUXHA	21	345,90	289	99.965,10	
ASLLAN		DERVISHI					
BAKSHIM		DERVISHI					
SULEJMAN		DERVISHI					
MERSIN		DERVISHI					
QAMILE		DALLASHI(DERVISH)					
SHPRESA		ALLDERVISHI(Dervishi)					
MEREME		TAFA(Dervishi)	20/28	339,60	289	98.144,40	
			ZONA KADASTRALE **1978**			*ZVRPP* **TIRANE**	
			ZONA KADASTRALE **2947**			*ZVRPP* **TIRANE**	
			ZONA KADASTRALE **1433**			*ZVRPP* **TIRANE**	
			ZONA KADASTRALE **2735**			*ZVRPP* **TIRANE**	
ISMAIL	SADIK	HYKA	194/1	327,80	448	146.854,40	
			ZONA KADASTRALE **1604**			*ZVRPP* **TIRANE**	
GENTIAN	HASAN	DALLASHI	459/5	277,80	3.283	912.017,40	
		QARKU **TIRANE**	*ZONA KADASTRALE* **1604**			*ZVRPP* **TIRANE**	
		QARKU **TIRANE**	*ZONA KADASTRALE* **1605**			*ZVRPP* **TIRANE**	
SHABAN	XHEMAL	PLAKU	331/10	286,30	2.560	732.928,00	
		QARKU **TIRAN**	**E** *ZONA K* *ADASTRAL* *E* **3266**				*ZVRPP* **TIRANE**
		QARKU **TIRAN**	**E** *ZONA K* *ADASTRAL* *E* **3292**				*ZVRPP* **TIRANE**
ALFRED	MASAR	SOJLI	116/12	16,20	3.413	55.290,60	
ENGJEL	EQEREM	PERNASKA					
SEMIHA	BEQIR	HASKU	116/11	276,00	3.413	941.988,00	
SUZANA	QAZIM	QOSJA	116/10	37,80	3.413	129.011,40	
ZYBEJTE	QAZIM	QOSJA					
AFERDITA		BODO					
ELSA		BODO					
ERION		BODO					
ALTIN		BODO					
NEVILA		BODO					
GANI		BODO					
LINDITA		XHYHERI					
ISUF		BODO					
FATIME		BODO	50/60	48,87	8.300	405.621,00	
BESNIK		MALAJ	50/61	23,98	8.300	199.034,00	
DULE		MALAJ	50/42	5,99	8.300	49.717,00	
ADEM	MUHARREM	JOCA					
MAHMUDE	MUHARREM	JOCA	4/349	6,40	66.969	428.601,60	
ENGJELL	FEJZO	GORISHTI	4/627	38,90	30.783	1.197.458,70	

Kompensimi i Pronarëve							
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensi mit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Viera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)	17
AFERDITA		KONGOLI					
AGIM		BAKALLI					
AGRON		EREBARA					
ALMA		KELLEZI					
AMANTA	SHABAN	JASA					
ARJAN		BAKALLI					
BUJAR		EREBARA					
EDLIRA		MUÇA					
EDMOND		EREBARA					
EMINE		GJEVOÇI					
ENGJELLUSHE		KOKONOZI					
ENKELEJDA		SHAHU					
ERVIN		BAKALLI					
FATIME		BAKALLI					
FATIME		GORENCA					
FATMIRA		KELLEZI					
HALIT		BAKALLI					
HAMIT		KOKONOZI					
HANKE		MATJA					
HASAN		CARA					
IDLIR		LOPÇI					
ILIR		PERNASKA					
IRMA		KELLEZI					
ISMETE		NDROQI					
KLITON	MYFIT	LOPÇI					
LAVDIE		BAKALLI					
LAVDIE		KOKONOZI					
LEJLA		BASHA					
LEJLA		KOKONOZI	3/244	0,70	30.783	21.548,10	SEKUESTRO KONSERVATIVE NR.690-11 REGJ., NR.02152 PROT., DT.24.01.2013, "SHERBIMI PERMBARIMOR ZIG" ME NR.DOK.00005706, DT.14.05.2014
LINDITA		KELLEZI					
LULJETA		KOKONOZI					
LUMTURIJE		EREBARA					
LUMTURIJE		VOGLI					
MEVLUDE		DENAJ					
MIMOZA		CARA					
MIMOZA		KOKONOZI					
MIRELA		QENAMAJ					
MUHAMET		DANAJ					
MUHAMET		VOGLI					
MYZEJEN		VOGLI					
NAXHI		BAKALLI					
OSMAN		DENIA					
QAZIM		BAKALLI					
QEFSERE		VOGLI					
RAMADAN		KELLEZI					
RIZA		BASHA					
SADETE		KELLEZI					
SEMIHA		LILA					
SHABAN		PLAKU					
VJOLLCA		KARAJ					
YLBER		KOKONOZI					
AFERDITA		KONXHOLLI					
AFRIM		STANGA					
HAJRIE		ÇIZMJA					
HAXHI		STAFA					
ISHE		STAFA					
MYZEJEN		MURTHI					
NADIRA		BACELLI					
SELIM		STAFA					
VAJE		STAFA	2/199	10,77	33.755	363.541,35	
AFERDITA		KANXHELI					
ALBANA		THODHORI					
HAJRIE		CANI					
HAXHI		CANI					
ISHE		CANI					
MYZEJEN		CANI					
NADIRE		CANI					TITULLI I KESAJ PRONESIE PERFSHIN EDHE PASURINE 2/498 TE KUFIZUAR PER ARSYE TE MBIVENDOSJES
SELIM		CANI	2/500	5,60	33.755	189.028,00	
ALBANA	BAFTJAR	TUSHA (PETI)	7/268	1,90	30.158	57.300,20	
ATLIJE	ZENEL	XIBRAKU	7/238	2,20	30.158	66.347,60	KUFIZIM I VEPRIMEVE me Nr.Dok.: 00004660, Dt.13.11.2012.
ANTON	ZEF	KOLIQI					
EVGJENI	PANO	KOLIQI					
KLARA	ZEF	PANARITI					
MIRJAM	ZEF	KOLIQI	3/179	16,90	66.969	1.131.776,10	
ZEF		RAKACOLLI	7/229	34,20	66.969	2.290.339,80	
TEODORA		KOTE					
SHAZIJE		GRUBLLESHI					
XHEMAL		GRUBLLESHI					
SIRI		GRUBLLESHI					
FESTIM		GRUBLLESHI					
KUDRETE		GRUBLLESHI					
NAZMIJE		GRUBLLESHI					
MAKBULE		GRUBLLESHI	4/275	62,50	66.969	4.185.562,50	

Këshilli i Ministrave: Masa e njëjtë për institucionet shëndetësore publike e private

Paketat e reja të shërbimeve mjekësore, të financuara nga shteti

Radioterapia e katarakta mbulohen nga Fondi

Voltiza Duro

Këshilli i Ministrave, me aprovim të kryeministrit Edi Rama, vendosi miratimin e një ndryshimi për paketat e shërbimeve shëndetësore që financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm. Ky vendim është bërë publik ditën e djeshme dhe ka hyrë në fuqi menjëherë me botimin e saj në Fletoren Zyrtare. Respektivisht, sipas vendimit, paketa e trajtimit të kataraktës dhe ajo e shërbimeve të radioterapisë do të marrin tashmë financim nga ky fond sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor për spitalet. "Këshilli i Ministrave vendosi: Shtojcat 6 dhe 7 që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij",-citohet në Fletoren Zyrtare. Disa prej paketave që financohen nga shteti përfshijnë shërbimet e dializës, ato të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë. Por, gjithashtu, edhe paketa e shërbimit të transplantit të veshkës e paketa e shërbimit të implantit koklear financohen drejtpërdrejt nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor. Ky i fundit financon të gjitha paketat e mësipërme në institucione shëndetësore publike, në përputhje me kapacitetet e tyre për ofrimin e shërbimeve të paketave. Për rastet që janë përtej kapaciteteve mjekësore të institucioneve shëndetësore publike, Fondi lidh kontrata dhe financon shërbimet e paketave në institucione shëndetësore private. Në vendim, gjithashtu, theksohet se çmimi i paketave të shërbimeve shëndetësore financohet nga Fondi në masë të njëjtë, si në institucionet shëndetësore publike, ashtu dhe në ato private. "Personat e siguruar që përfitojnë nga këto paketa janë të përjashtuar nga bashkëpagesa",-citohet më tej në vendim. Ndërkaq, Fondi ngre strukturat për auditimin dhe monitorimin e ofrimit të paketave të shërbimeve nga institucionet shëndetësore publike dhe private të kontraktuara. Çmimet e paketave të shërbimeve shëndetësore rishikohen çdo vit nga një komision i rishikimit të çmimeve të paketave, i cili caktohet nga Këshilli Administrativ i Fondit, me pjesëmarrës nga shërbimet shëndetësore publike dhe private, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Fondit. Ndryshimi i çmimeve bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

LISTA E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Shtojca 6

	Kostoja 2017	Njësia	Marzhi i fitimit	Çmimi i paketës
Paketa e trajtimit të kataraktës	20,157	lekë për paketë	8%	21,770
Në këtë paketë përfshihen:				
Kryerja e interventit				

Shtojca 7

Paketa e shërbimeve të radioterapisë (me akselerator linear)	Kostoja 2017	Njësia	Marzhi i fitimit	Çmimi i paketës
Paketa e trajtimit paliativ (1–10 seanca trajtimi)	7,068	lekë për seancë	5%	7,421
Në këtë paketë përfshihen: ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe seancat me akselerator linear.				
6537 Paketa e trajtimit adjuvant/ neoadjuvant (15–33 seanca trajtimi)	5,780	lekë për seancë	5%	6,069
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear.				
Paketa e trajtimit radikal (15–35 seanca trajtimi)	6,031	lekë për seancë	5%	6,333
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear.				
Paketa e trajtimit me IMRT (15–39 seanca trajtimi)	6,053	lekë për seancë	5%	6,356
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear (IMRT)				

Faksimile e vendimit të Këshillit të Ministrave

VENDIMI

Ky vendim është bërë publik ditën e djeshme dhe ka hyrë në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare. Respektivisht, sipas vendimit, paketa e trajtimit të kataraktës dhe ajo e shërbimeve të radioterapisë do të marrin tashmë financim nga ky fond sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor për spitalet.

FINANCIMI

Në vendim, gjithashtu, theksohet se çmimi i paketave të shërbimeve shëndetësore financohet nga Fondi në masë të njëjtë, si në institucionet shëndetësore publike, ashtu dhe në ato private. "Personat e siguruar që përfitojnë nga këto paketa janë të përjashtuar nga bashkëpagesa", citohet më tej në vendim.

bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz

LAJMËRIM PËR TENDER KUALIFIKIMI PARAPRAK

1. Kushtet e përgjithshme

1.1 Kërkuesit : Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë
Adresa: Rr. Skënderbeg, Nr. 21/1

1.2 Profili : Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë që nga viti 1988 mbështet Shqipërinë në rrugën drejt Integrimit Europian dhe zhvillimit nëpërmjet projekteve që zbatohen në fushat: për Zhvillim Ekonomik, Reforma ligjore në ekonomi, Edukim dhe Kualifikim Profesional, Reforma në sektorin e ujësjellësit, dhe fusha të tjera.

1.3 Subjekti: GIZ fton Agjenci Udhëtimi të kualifikuara, anetare ne IATA të shprehin interes në sigurimin dhe menaxhimin e shërbimeve të udhëtimeve sipas kërkesave të Zyrës së administratës dhe të Projekteve të GIZ.
Profili i udhëtimeve të GIZ është kryesisht Tiranë - Gjermani - Tiranë, sipas nevojës dhe në vënde të tjera.
Të gjithë subjektet ligjore të interesuar në proçesin e aplikimit duhet të kërkojnë një formë aplikimi ne adresën; giz-albanien@giz.de

1.4 Data përfundimtare për pranimin e aplikimit të plotësuar në Anglisht është **26 Janar 2018.**
Dokumenti i plotësuar në mënyrë të saktë, duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur, të vulosur me mbishkrimin:
Aplikim për kualifikim paraprak "Menaxhim Shërbime Udhëtimi" adresuar tek
Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë,
Rr. Skënderbej, Nr. 21/1
Tiranë

Proçesi i kualifikimit do të fillojë pas datës së mbylljes së aplikimit.
Aplikimet do të vlerësohen dhe vetëm kandidatët e kualifikuar do të ftohen të marrin pjesë në tender.

Nikolla: Rezultatet e larta falë reformës në arsim

Diplomohen 1963 studentë të Ekonomikut, dekani: Të ribashkohet Universiteti i Tiranës

Dekani Dhori Kule

Për të rritur cilësinë e arsimit të lartë e përgatitjen e studentëve në tregun e punës, është i nevojshëm ribashkimi i Universitetit të Tiranës. Kjo deklaratë u bë ditën e djeshme nga dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Dhori Kule gjatë ceremonisë së diplomimit të 1963 studentëve të këtij fakulteti. "UT, krahasuar me mesazhin e bashkimit që përcjell Viti i Skënderbeut, për fat të keq ka pësuar praktikën e copëtimit. Ndaj nuk ka ditë më të bukur se Viti i Skënderbeut, i cili promovon bashkimin për të ribashkuar UT, ashtu siç janë të gjithë kolegët në Europë. I bashkuar, i madh, i fuqishëm, cilësor çdo pjesë brenda të madhes është më e fuqishme", - tha dekani. E pranishme në këtë ceremoni, ishte edhe ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla, e cila theksoi se Fakulteti i Ekonomisë është një ndër më të preferuarit e studentëve e nuk la pa përmendur edhe rezultatet e larta të të rinjve falë reformës në arsim. "Ne do të bëjmë të gjitha detyrat e shtëpisë, por modestisht, përulësisht bëni dhe ju detyrat e shtëpisë. Për vendet që janë bosh sot këtu të autoriteteve të rëndësishme të UT përpara se të bëjmë bashkimin e madh të Universiteteve të bëjmë këtë bashkimin e vogël të përgjegjësive për të vijuar më shumë, më fort me treguesit e arritjes", - u shpreh Nikolla.

Projekti, si do të shndërrohet këndi i lojërave "7 xhuxhat" në kryeqytet

Zona e njohur si këndi i lojërave "7 xhuxhat", në afërsi të rrugës së "Elbasanit", do të marrë një pamje krejtësisht të re, duke ofruar një kënd modern lojërash për fëmijë dhe ambiente çlodhëse për të rriturit. Projekti i ri ka nisur të zbatohet e konsiston në një rikonceptim të parkut të lojërave të fëmijëve. Bashkia e Tiranës, nëpërmjet kësaj nisme do të mundësojë edhe krijimin e një parkingu nëntokësor publik në këtë zonë, çka do të ndihmojë në lehtësim e qarkullimit të automjeteve. Parashikohet që ky park i ri të ketë hapësira të mjaftueshme për të gjithë vogëlushët si dhe do të ofrojë lulishte e gjelbërim për më të rriturit. Parkingu nëntokësor do të krijojë hapësirat për një numër të konsiderueshëm vendesh parkimi për banorët e zonës dhe bizneset përreth.

BLUE TOOTH
Thashetheme
MADE IN ALBANIA
Nr. 593
SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE
Art Designer: Nevila Samarxhi
E shtunë 13 Janar 2018

SARA KAPO: Eros apo vulgaritet? Ja cili është limiti im

Flet vajza e Ema Andreas: Ju rrëfej kur do të vijë "provokimi" i radhës

"DUA TE TE BEJ TE LUMTUR"

Këtë vit me personazhe VIP, përgatituni për emocione të bukura



Pushimet superluksoze, ja ku po e kalon "muajin e mjaltit" Angela Martini



Flet vajza e Ema Andreas: Ju rrëfej kur do të vijë "provokimi" i radhës

SARA KAPO:

Eros apo vulgaritet? Ja cili është limiti im

"Kënga është thjesht një flirt, fun, tapë... jam vetëm 23 vjeçe"

PAMELA ALIAJ

Të jesh provokuese dhe të guxosh të vish ndryshe nuk është e lehtë, edhe pse ditët e sotme njerëzit "ngatërrojnë" vulgaren me erosin dhe atë që mund të quhet thjesht art. Ajo ka qenë shpeshherë në qendër të mediave rozë duke spikatur nga vajzat e tjera jo për faktin se është e bija e një artisteje, por për stilin e saj të veçantë dhe provokues. Po flasim pikërisht për Sara Kapon, vajzën e aktores Ema Andrea, e cila falë stilit krejt të sajin është vënë në qendër të vëmendjes. Në një intervistë eksklluzive për "Bluetooth", të "Gazeta Shqiptare", Sara ka folur për këngën e saj të parë të sjellë në anglisht "Watching you" (Jam duke të parë). Sara ka folur për faktin se pse parapëlqen të vijë e tillë në videoklip e kudo në shfaqet e saj provokuese dhe plot eros. Gjithashtu ajo ka folur për burimin e frymëzimit të saj. A do të guxojë sërish me eros? Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Jeni një vajzë tepër e veçantë në stilin dhe mënyrën tuaj të të shfaqurit në publik. Cili ka qenë faktori apo personi, i cili ka ndikuar në formimin tuaj?

Më bëhet qejfi që dëgjoj këtë për veten njëherë (qesh). Besoj se komplet mënyra se si më ka ardhur jeta për disa gjëra dhe fakti që kam qenë gjithmonë afër artit edhe në backstage më ka bërë të kem disa shije ndoshta pak më të çuditshme se shumica.

Jeni përfolur shpesh për daljet tuaja ekstravagante e të veçanta si në fotot nudo edhe në puthjet me një femër. Përse një shfaqe e tillë? Çfarë do të përcjellë Sara?

Nuk është se Sara është shfaqur kështu, kam shumë e shumë gjëra të tjera. Janë gazetarët që zgjedhin të shkruajnë vetëm për to. Bëhet lajm një puthje në faqe me një femër, por asnjëherë nuk e kam parë lajmin ku filmi, që kam marrë unë pjesë si aktore kryesore do të shkojë në Paris të përfaqësojë Shqipërinë. I them gjithmonë, nuk ka problem se bëni skandalet, por ku janë lajmet për punët e mia? Nuk është të paktën një njeri i dedikuar për këto?

Cila është muza juaj?

Është e kotë të them përsëri mami, sepse përveçse është e qartë, e kam thënë sa herë më kanë pyetur. Por çfarë më ka ndodhur së fundmi është që vetja ime ka filluar të më frymëzojë. Shoh prapa dhe ndihem mirë që jam krenare për disa arritje dhe procese të miat.

Kush është kritiku/ja më e madhe e juaja?

Vetja ime. Ndonjëherë jam shumë e ashpër me të.

Sara ka pasur një tip e stil të tillë gjithnjë apo ka pasur një moment në jetë që e ka ndryshuar? Cili ka qenë ai nëse po, dhe pse?

Të them të drejtën stili im ka ndërruar shpesh. Nuk

kam qenë gjithmonë kështu, të paktën për sa i përket veshjes ose paraqitjes. Tani që jam më e pjekur, përpiqem të bëj një kombinim të të gjitha fazave që kam kaluar më parë në një.

Keni nxjerrë një videoklip me këngën tuaj të parë "Watching you". Si lindi gjithçka?

Kisha shumë dëshirë të prodhoja një këngë dhe "Tull Production" kishte disa propozime interesante në kohën që unë doja ta bëja këngën. Duke provuar, duke parë, ramë të gjithë dakord që kjo këngë ishte mënyra më e mirë për të dalë dhe nuk do të doja të kisha bërë me asnjë tjetër. Jam shumë e kënaqur me këtë projekt.

Sërish provokuese Sara në video. Ka një qëllim apo një mesazh në të?

Si provokim? Sepse është diçka e thjeshtë dhe fun? Nuk ka mesazh, duhet të ketë gjithmonë? Është gjendje, flirt, fun, tapë... 23 vjeç jam nuk kam ndonjë mesazh aq të thellë për botën që do i ndihmojë të kalojnë ditë të vështira.

Muzika për Sarën është një "provë" e momentit apo është...

Ka qenë dhe është pasion, por këtë këngë mund ta quaj vetëm 1 për qind provë, sepse mendoj se është punë shumë e mirë për ta quajtur vetëm aq.

Si erdhi ideja e bashkëpunimit me vëllezërit Ramosaj? Si lindi gjithçka?

Me Ramosajt kam pasur më parë një raport shumë miqësor. Për të dy kam pasur një respekt shumë të madh që para se të bashkëpunonim për këngën dhe jam ndjerë me fat të punoja mes miqsh që të duan të mirën.

Çfarë quan të tepruar Sara?

Vallaj vetëm me ushqimin (qesh).

Kush do ishte kulmi i arritjes për Sarën?

Sikur të hapja Biennalen e Venzias dhe të kisha një drejtim muzikor të konsoliduar.(Qesh)

Çfarë do të doje të "guxoje" sërish pas puthjeve me një femër dhe daljeve nudo e provokuese?

Ja të shohim për ndonjë projekt tjetër nga shkurti.

Çfarë i është dukur provokuese apo vulgare Sarës?

Provokuese nuk është kollaj të quaj diçka, nuk impresionohem aq shpejt, por për sa i përket vulgaritetit, thjesht nuk më pëlqen të jem pjesë. Diçka pa shije me duket vulgare, pavarësisht sasisë së erosit të përfshirë.

KENGA

Si provokim? Sepse është diçka e thjeshtë dhe fun? Nuk ka mesazh, duhet të ketë gjithmonë? Është gjendje, flirt, fun, tap... 23 vjeçe jam nuk kam ndonjë mesazh aq të thellë për botën që do i ndihmojë të kalojnë ditë të vështira.

EROS APO VULGARE?

Provokuese nuk është kollaj të quaj diçka, nuk impresionohem aq shpejt, por për sa i përket vulgaritetit, thjesht nuk më pëlqen të jem pjesë. Diçka pa shije me duket vulgare, pavarësisht sasisë së erosit të përfshirë.

"Dua të të bëj të lumtur", këtë vit me personazhe VIP

Përgatituni për emocione të bukura

Programi "Dua të të bëj të lumtur", i drejtuar nga Arbana Osmani, vjen në edicionin e tij të dytë në 16 javë transmetim, ku do të tregohen historitë më të jashtëzakonshme të njerëzve të zakonshëm, me pjesëmarrjen e personazheve më të dashur të jetës publike në Shqipëri. "Dua të të bëj të lumtur", me autorë Eraldo Rexho dhe Osmani, do të vijë së shpejti çdo të shtunë në prime time, në ekranin e "Top Channel" me katër histori me tematika të ndryshme nga njëra-tjetra ku përfshihen: konflikti, dashuria, frymëzimi dhe situatat gazmore. Këtë vit, në ndryshim nga edicioni i parë, programi do të përfshijë çdo javë personazhe të dashur të jetës publike. Disa nga personazhet VIP janë pa dijeninë e tyre protagonistë të historive, të ftuar nga të afërm, që kanë diçka për t'u thënë; ndërsa disa të tjerë janë të ftuar si pjesë e surprizave për fansat e tyre, pjesë e historive tona, duke u angazhuar në mënyra të ndryshme për t'u realizuar dëshirat. Emrat më të njohur nga ekrani, muzika, politika dhe sporti kanë pranuar të jenë pjesë e emisionit, për të ndihmuar në misionin tonë për të bërë të lumtur sa më shumë njerëz. Ata do të dalin nga formati në të cilin jemi mësuar t'i shohim, duke shfaqur një tjetër anë të tyren. Emisioni që premton shumë emocione te njerëzit vjen së shpejti në muajin shkurt me shumë të papritura. Disa prej "momenteve" të shkëputura janë transmetuar edhe nga vetë moderatorja, Arbana, në faqen e saj në "Instagram". Autorët kanë vendosur që të sjellin histori mbresëlënëse, plot magji e emocion të shkëputura nga jeta e shqiptarit në vende të ndryshme të Shqipërisë. Vip-at do të jenë në një mënyrë pjesë e pandarë e çdo puntate duke i bërë ato edhe më interesante përveç ndjenjës njerëzore të çdo rasti të sjellë nga seria në seri. Në postimet e bëra në "Instagram" duket se nuk do të mungojë as vendi i lindjes i vetë moderatores dhe bashkëautores, Arbana Osmani, Maqellarë. "Dua të të bëj të lumtur" premton lot gëzimi dhe shumë emocione. Të papriturat janë rezervuar të gjitha në shkurt. Mezi presim të jemi pjesë e tyre!





Rikthehet Sokol Balla, kësaj radhe supersticioz?!

Ai është rikthyer pas shkëputjes nga "TCh" për herë të parë në një tjetër televizion vetëm para dy ditësh. Gazetari Sokol Balla ka nisur punën si drejtor ekzekutiv në "Vizion Plus" në datën 11 janar. Gazetari dhe moderatori i një emisioni politik që pritet të fillojë shumë shpejt në këtë televizion ka zgjedhur të shkojë në punë në orën 11:11. "Ora 11:11, 11 janar. Dita e parë e punës së re" - ka shkruar Balla në "Twitter". Tashmë gazetarin do e shohim në ekran çdo të hënë dhe të enjte në orën 21:00. Është përfolur shumë largimi i gazetarit Sokol Balla nga 'Top-Channel' dhe emërimi i tij si drejtor ekzekutiv në 'Vizion Plus'. Disa burime për 'IMAlbania.com' konfirmojnë se Sokol Balla është prezantuar nga drejtuesit e televizionit 'Vizion Plus' si drejtori i ri ekzekutiv. Gjithashtu, ai pritet që të fillojë përsëri një program politiko-debat si modeli i 'Top-Story'. Ky program i ri emri, i të cilit ende nuk dihet, do të transmetohet të hënën dhe të enjten në orën 21:00.

Këngëtarja e njohur ndahet me vëllain e Blerim Destanit

Shpesh është përfolur kohët e fundit lidhja e dashurisë së këngëtares shqiptare me vëllain e Blerim Destanit. Shkurte Gashi ka qenë ajo që e pranoi vetë publikisht se ishte në një lidhje në "Zhurma Show", ku i dedikoi atij edhe çmimin që kishte fituar. Gjithsesi, sipas mediave rozë Shkurte dhe Selimi i kanë dhënë fund lidhjes së tyre, dhe vëllai i Destanit është larguar jashtë vendit me gruan dhe fëmijët. Ende nuk është dhënë një prononcim i qartë nga asnjë palë, por largimi i tij lë dyshime se ndarja mund të ketë ndodhur vërtet.

Zbulohet çmimi i çmendur i unazës së fejesës së Adelina Tahirit

Ajo ka qenë në qendër të mediave rozë duke qenë se para pak ndërrimit të viteve kurorëzoi dashurinë e saj me martesë. Adelina Tahiri në fillim bëri publike fejesën e saj me avokatin 50-vjecar Serjozha Markov, gjë që ishte e papritur për të gjithë pastaj celebrimin. Lajmin e dha ajo nëpërmjet fotove të publikuara në "Instagram". Mes këtyre fotove këngëtarja nuk harroi të ndante me publikun unazën e shndritshme të fejesës. Së fundmi, është zbuluar se unaza është e firmës së njohur 'Cartier' dhe është me përbërje diamanti, një unazë mbresëlënëse që çdo vajzë do të donte ta kishte. Por akoma edhe më mbresëlënëse është shuma e çmendur, e cila është shpenzuar për këtë unazë. Faqja 'Whatthaywearing" ka publikuar një foto të unazës dhe tregon se ajo ka kushtuar 5360 euro. Me siguri Adelina është ndier shumë e vlerësuar pasi ka marrë këtë unazë.



Jon Gjebrea ia bën "bam" për herë të dytë, ja ku e feston fejesën kësaj radhe

Nuk u mjaftua vetëm me fejesën familjare e cila ishte shumë përfolur në media, por djali i moderatorit të njohur Ardit Gjebrea ka vendosur ta vijojë festën me shoqërinë. Jon Gjebrea dhe e fejuara e tij Merlin Haxhiymeri zyrtarizuan lidhjen e tyre disa vjeçare pak ditë më parë. Pasi u kthyen nga udhëtimi i tyre në Romë, çifti ka festuar bashkë me shoqërinë. Por këto momente Joni s'ka harruar t'i ndajë këto momente në rrjetet sociale ku dukej qartë se të gjithë po argëtoheshin në maksimum. Nga kjo fejesë u komentuan pa fund dhe 'shfaqjet artistike' që dha Anna, motra e vogël e Jonit. Gjithashtu, Merlin ka ndarë me miqtë unazën me gurë të çmuar që i dhuroi i fejuari.





Afërdita Dreshaj e marrosur pas të fejuarit, ja si ia shpreh dashurinë

Një tjetër këngëtare bukuroshe ka kurorëzuar dashurinë e saj para një muaji. Po flasim pikërisht për Afërdita Dreshajn, e cila tashmë prej disa vitesh i është përkushtuar vetëm jetës së saj private me të fejuarin çek. Vetëm në dhjetor ajo postoi lajmin e gëzueshëm se i kishte thënë "PO", propozimit për fejesë nga i dashuri i saj Jakub Kindl. Por, pas kësaj Afërdita shihet çdo ditë e më shumë e dashuruar me të fejuarin e saj çek. Këtë mund ta vëreni përmes imazheve që ajo publikon në rrjetet sociale. Së fundmi, Afërdita në "Instastory" ka publikuar një fotografi ku shihet së bashku me të fejuarin ku duken të lumtur krahë njëri-tjetrit. "Gëzuar për përjetësinë tonë", ka lënë mbishkrim Afërdita.

Pushime superluksoze, ja ku po e kalon "muajin e mjaltit" Angela Martini

Muaj mjalti apo thjesht pushimet e radhës? Angela Martini, modelja e njohur shqiptare është duke shijuar disa ditë me partnerin e saj në një nga vendet më të bukura ekzotike. Angela, që shquhet për linjat e saj trupore, vitin që lamë pas kurorëzoi lidhjen me të dashurin e saj, miliarderin rumun Dragos Savulescu. Tashmë modelja e famshme shqiptare Angela Martini bashkë me të shoqin po shijojnë muajin e mjaltit. Ajo spikati me ceremoninë martesore, e cila ishte vërtet e veçantë, asnjëherë e parë më parë nga VIP-at shqiptarë. Martesa me miliarderin rumun Dragos Savulescu e ka shndërruar bukuroshen shqiptare në një nga femrat më të lumtura. Pas pushimeve dimërore, momente nga të cilat Angela ndau me fansat e saj, çifti janë nisur për një tjetër destinacion. Video-ja është realizuar teksa çifti ishte në fluturim brenda avionit privat. Prej disa ditësh çifti po qëndron në Islandë duke shëtitur nga një ishull në tjetrin. Pamjet e mëposhtme i ka postuar sot vet modelja në "Instagram".

FUSHË KRUJË- Një tjetër shpërthim me tritol ka tronditur banorët e fshatit Halil në Fushë-Krujë. Mësohet se rreth orës 23:45 të së enjtes është djegur makina tip "Audi 80", në pronësi të 60-vjeçarit Kadri Voga, ish-efektiv policie. Policia, e njoftuar pas shpërthimit, mbërriti në vendin e ngjarjes ku konstatoi automjetin e djegur, i cili ishte në oborrin e banesës së ish-policit. Ky mjet herë pas here përdorej edhe nga i

Makina e djegur

Në oborrin e familjes u gjetën edhe dy granata të pashpërthyera

Tritoli shkrumbon "Audi"-n e ish-efektivit të policisë

biri, Agron Voga, punonjës i Policisë Rrugore në Tiranë. Nga këqyrja e parë u konstatua se ka pasur një shpërthim. Ndërkaq, hetuesit e çështjes po punojnë për të sqaruar nëse makina është djegur pasi ka shpërthyer, apo fillimisht i është vënë flaka dhe më pas ka shpërthyer. Nga ngjarja nuk pati të lënduar, ndërsa sipas policisë, ka dëme materiale. Gjatë kontrollit të perimetrit të sigurisë, hetuesit gjetën edhe dy granata të pashpërthyera. Ekspertët xhenierë kryen neutralizimin e granatave, të cilat ndodheshin në oborrin e shtëpisë së Vogës. Policia po e heton ngjarjen në disa pista që kanë të bëjnë konflikte të mundshme të ish-policit Kadri Voga, por edhe djalit të tij. Vetëm 6 muaj më parë, persona të paidentifikuar, i vunë eksploziv makinës së djalit tjetër të Vogës. Edhe në këtë rast policia nuk ka mundur të identifikojë autorët e krimit

Zhdukën kartelat e pronësisë, shkarkohen dy punonjës të Hipotekës

KORÇË - Dy specialistë të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Korçë, E.G. dhe A.P. janë shkarkuar nga detyra dhe ndaj tyre është depozituar kallëzimi penal pranë organit të prokurorisë së qytetit juglindor. Kryeregjistruesi, Elion Semanaj ka firmosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës për dy specialistët, pasi është verifikuar se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, ata kanë zhdukur dy kartela pronësie. Menjëherë është ngritur një grup pune dhe është kërkuar një hetim i brendshëm i institucionit. Në këto kushte, janë kontrolluar kamerat e sigurisë së institucionit dhe është evidentuar se dy punonjësit e zyrës, kanë bashkëpunuar në këtë vepër penale. Në këto kushte flagrance, kryeregjistruesi firmosi shkarkimin e tyre dhe nisjen e procedurave për depozitimin e kallëzimit penal ndaj dy vartësve të tij. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të vijojë të verifikojë çdo ankesë të qytetarëve për shërbimet që ofrohen pranë sporteleve të saj dhe do të godasë çdo rast abuzimi me detyrën apo më keq korruptiv nga punonjës të papërgjegjshëm të saj.

Arbër Sulo

Halim Ismaili: Nipin e lidhën dhe e gjakosën në shtëpi, policia të kapë autorët

Horror në Ksamil, maskat dhunojnë e grabisin me armë 23-vjeçarin

3 agresorët hynë në vilë, i morën dhe makinën

SARANDË

Horror në Ksamil. Maskat kanë dhunuar dhe grabitur një 23-vjeçar nga qyteza e Ksamilit. Ngjarja e rëndë ka ndodhur mëngjesin e së premtes, rreth orës 07:30. Mësohet se tre persona të armatosur dhe të maskuar kanë hyrë nga dera e pasme e vilës 4-she (përdoret si shtëpi pushimi gjatë sezonit veror), e cila ndodhet në rrugën që të çon te plazhi "Pema e Thatë", pronë e familjes Lula, e cila prej shumë vitesh punon e jeton në Greqi. Në shkallë, në katin e dytë të vilës, grabitësit janë ndeshur me të riun Petro Lula, i cili në atë kohë do të nisej për në shkollë, pasi është student në Universitetin e Tiranës, filiali Sarandë, në vitin e parë në degën anglisht. Në përballjen e papritur me agresorët, i riu nuk ka mundur të bëjë dot asgjë për vetëmbrojtje. Ai është rrahur keqas e goditur me qytën e armës deri në gjakosje, dhe më pas është lidhur. Grabitësit i kanë marrë studentit çelësat e banesës dhe më pas kanë hyrë brenda. Burime nga policia pohuan se autorët kanë marrë një sasi prej 700 eurosh në shtëpinë e Lulës, si dhe makinën "Benz", me targa AA 322 DP që ndodhej në oborr dhe më pas janë larguar. Blutë të njoftuar në telefon nga vetë i dhunuari kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Gjithashtu, policia ka ngritur pika kontrolli me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorëve të krimit. Ndërkaq, grupi hetimor ka nisur punën për zbardhjen e plotë të ngjarjes. I dhunuari, Petro Lula, është marrë nga të afërmit e tij dhe është dërguar për ndihmë mjekësore në spitalin e Sarandës. Ndërkohë që janë njoftuar edhe prindërit e tij në Greqi, të cilët janë nisur drejt Ksamilit.

23-vjeçari Petro Lula, që u grabit nga maskat

Vila e familjes Lula ku ndodhi ngjarja

FAMILJARËT E STUDENTIT

Pas ngjarjes "GSH" ishte në vilën ku ndodhi grabitja. Halim Ismaili, gjyshi i 23-vjeçarit Petro Lula (babai i të ëmës) tha se ishte shokuar nga ajo që i ndodhi nipit. "Unë jam gjyshi i djalit. Më njoftuan nga Saranda. Djali vete në shkollë, është në universitet. Ai fle në katin e tretë të shtëpisë së tij. Në orën 07:30, nipi ishte duke zbritur shkallët, kur u përball me grabitësit, të cilët e rrahën, e lidhën dhe e lanë ashtu të lidhur dhe më pas kanë kontrolluar e bastisur banesën. Nuk jam në gjendje të them se çfarë kanë marrë, deri edhe serverin e kamerave të shtëpisë. Djali rrinte vetëm në shtëpi, pasi ime bijë dhe dhëndri punojnë në Greqi. Kur më thanë për grabitjen, mendova se kishte vdekur. Ku nuk e kanë goditur dhe gjakosur. Po shyqyr që e lanë të gjallë. Nipi ka dy vjet që ka ardhur nga Greqia dhe nuk ka pasur hasmëri me asnjë person. Nuk kemi pasur asnjëherë probleme me askënd. Edhe makinën ia vodhën. Ma tmerruan nipin të këqijtë që rrojnë me vjedhje", tha Halim Ismaili. Ndërkaq, i moshuari u bëri apel policisë dhe prokurorisë që të identifikojnë dhe të venë në pranga autorët.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR

Në zbatim të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 184, neni 8, datë 17.03.2010, Komisioni i Prokurimit Publik shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat: Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinjer elektronik/informatik; inxhinjer mekanik; inxhinjer hidrologjik; inxhinjer elektrik; inxhinjer gjeologji-minierash; inxhinjer mjedisi; inxhinjer ndërtimi; inxhinjer tekstile; kimist; specialist në farmaceutikë.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat :
1.Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2.Të ketë licensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e expertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapagim nga pala ankimuese.

Kandidati duhet të paraqesë **brenda datës 09 Shkurt 2018** në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të lincensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, fotokopje te kartës së identitetit, një numër telefoni për t'u kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,120,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë**"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Shkurt 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

LAMTUMIRA

SHUHET *Rexhep Çeliku*

Lili Cingu: La amanet që të mos ndalë vallja

Ndahet nga jeta për shkak të një sëmundjeje të rëndë valltari "Nder i Kombit"

Fatmira Nikolli



Fluturues në skenë dhe i rëndë në tokë, "shqiponja" e valles shqipe, nisi fluturimin e fundëm.

Dje në orët e para të mëngjesit, është ndarë nga jeta në shtëpinë e tij, pranë bashkëshortes Loli, "Nderi i Kombit", Rexhep Çeliku. Valltari e koreografi i njohur i Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore vuante prej vitesh nga një sëmundje e rëndë, luftën me të cilën pas mjekimeve në spitale brenda dhe jashtë vendit, e humbi duke gdhirë e premtja. Mjeshtri u shua në shtëpinë e tij në Tiranë në moshën 64-vjeçare, rreth orës 03:30 të mëngjesit të së premtes. Homazhet në nderim të tij do të mbahen në Muzeun Historik Kombëtar, ditën e shtunë nga ora 11:00-13:00. Vetëm pak ditë më parë, ai u shfaq për herë të fundit në publik, i vlerësuar nga presidenti me titullin "Nderi i Kombit". Titulli iu dha "në vlerësim të kontributit të jashtëzakonshëm si solist me nivel të lartë dhe mjeshtëri të veçantë artistike në interpretimin e valleve shqiptare; për promovimin denjësisht të vlerave të mirëfillta të trashëgimisë sonë kulturore kombëtare brenda dhe jashtë vendit, si dhe për pasurimin e fondit të krijimtarisë koreografike dhe përçimin e tij tek brezat e artistëve të rinj". Dhe iku në kulmin e lavdisë.

"Rexhep Çeliku, biri i një gjirokastriti, mjeshtër në nxjerrjen dhe gdhendjen e gurit, e më vonë si restaurator i kishave dhe xhamive në Tiranën e paraçlirimit, vazhdoi traditën shqiptare në gdhendjen e valles popullore në tempullin e kulturës - Ansamblin e Shtetit si 'Valltari fluturues', sikundër e ka karakterizuar kritika artistike shqiptare dhe e huaj", shkruante Lefter Çipa. Sipas tij, Rexhep Çeliku ka interpretuar solistin e parë në 200 valle, ka marrë pjesë në 500 shfaqje në skena të ndryshme në tri kontinente, në 30 festivale ndërkombëtare dhe ka interpretuar në më shumë se 3000 shfaqje artistike. Figura emblematike dhe e veçantë e tij në skenë, kaq emocionuese sa edhe mbresëlënëse në portretin e tij të hekurt, por edhe në gjithë gjymtyrët e tij, me të drejtë është simbolizuar në thënien tronditëse "Njeriu që vallëzon me shqipet", shënonte Lefter Çipa. Partnerja e tij disa vjeçare në skenë, Lili Cingu, në një intervistë për "GAZETA SHQIPTARE" rrëfen kujtimet e vlerësimet për të.

- Kur ka qenë dita e fundit që e keni takuar ju Rexhep Çelikun?

Nuk ka pasur asnjë moment, asnjë sekondë që të mos e takoj Xhepin. Nuk mund të flas për takim të fundit. Xhepit nuk i thërrisja me emër, e kisha vëlla e më tepër se vëlla. Në çdo aktivit ne ishim bashkë, si ditën kur morëm titullin "Nderi i kombit" nga presidenti Ilir Meta.

Dy ditët e fundit ishte rëndë. Nuk doja kurrë ta shihja Xhepin rëndë, desha ta mbaja mend si një shqiponjë, si një legjendë që skenat i prekte dhe i tha botës që ky është arti shqiptar, e kjo është vallja shqiptare. Për ne, Rexhep Çeliku jeton, Rexhep Çeliku është në zemrat tona. Është në zemrat e çdo shqiptari kudo që ndodhet. Nuk kanë të reshtur telefonat, ngushëllimet e njerëzve që e kanë njohur nga e gjithë bota. I them tani Rexhepit na le, por nuk ia them dot. Rexhepi po fluturon në qiell, si ajo shqiponja që prek qiellin dhe skenën.

- Hera e fundit bashkë në skenë, keni qenë në përvjetorin e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve popullore?

Në përvjetorin e 60-të të Ansamblit, ne ishim bashkë. Isha e ftuar si artiste me rastin e përvjetorit dhe nderimit të institucionit me titullin "Nderi i Kombit" dhe valltarit të madh Besim Zekthi. Marrja e titujve për ne si çift ishte një moment i bukur, u ndjemë krenar.

- Kur e morët titullin ju, ditën që doli në media?

Titujt jepen kur janë për tu dhënë. Ne do e merrnim këtë muaj, sepse është përvjetori e muaji i Skënderbeut. Dhe nuk ka gjë më të bukur se sa ta merrnim këtë titull në janar. Atë krenarinë që kemi dhënë në skenat tona, do e mbajmë me nder.

- U gëzua Çeliku?

Po, patjetër që u gëzua. E priti shumë mirë, edhe pse gjendja shëndetësore ishte, siç ishte. Titulli dhe humbja e Xhepit më bën tani që të kërcej derisa të kem frymë, edhe për vetë edhe për atë, sepse sa herë të dal në skenë, do mendoj se e kam Rexhepin në krahun tim të djathtë.

- Do kërceni për partnerin tuaj historik?

Do kërcej për të, e kur të dal në skenë do hap krahun për të. Është parteri im historik sepse kam kërcyer me të që prej 1971-it, e më parë me Besim Zekthin. Kur unë të dal së shpejti e ftuar, kur të hap krahun, kur të tund shaminë, do kujtoj Rexhepin dhe do kërcej për të, do kërcej me të.

- Çfarë mbresash ju ka lënë në më shumë se 40 vite së bashku?

Të flasësh për të, duhet net e ditë pa fund. As nuk mjaftojnë. Rexhepi nuk ka qenë vetëm valltar. Ka qenë një familjar i shkëlqyer që ka krijuar një familje të shëndoshë dhe të mirë. I përkushtuar pas dy vajzave që i shkolloi dhe i rriti mirë. Ka një grua të mrekullueshme, e cila për mua është "Loli, motra ime". Ai ka qenë i gjithanshëm. Nëse e shihje duke kërcyer, ai ishte edhe koreograf, e shihje edhe duke vepruar, edhe duke drejtuar, edhe si regjisor, edhe si skenograf.

- Keni kërcyer edhe jashtë, përveç se në Shqipëri. A kishit plane së afërmi?

Kanë qenë të shumta aktivitetet me të. Kemi qenë në Itali, për përvjetorin e Pavarësisë, në festën e Flamurit, me 25 nëntor. Na ftuan të dyve dhe prania jonë atje, bëri jehonë të madhe. Rexhepi kërceu edhe në 60-vjetor dhe në shkurt unë e Rexhep do të ishim në Kosovë për 10-vjetorin e Pavarësisë. Edhe pse gjendja u rëndua, ai e kish vendosur që ne të iknim. Mund të thuhet se na la, por jo, s'na ka lënë. Do jetë një shqiponjë që na shikon nga qielli. Është një krenari për vendin tonë, sepse edhe gurët ku kalonte ai po e vajtojnë ikjen e tij. Jeton në vallet tona, në skenat tona, në shpirtin tonë.

- A e pati ai ndihmën e duhur për trajtimet mjekësore? A gjeti mbështetjen nga institucionet?

Nuk dua të prek shumë gjëra, por nuk i ka munguar Rexhepit, ndihma për operacionin jashtë. As mjekimet këtu nuk i kanë munguar. Ndihma ka qenë, por ne artistët jemi pak njerëz që prekemi. Sëmundja bëri punën e vet dhe ai ishte shumë modest, shumë i thjeshtë. Shpesh, i thosha të udhëtonte mirë. Ishte krenar dhe thoshte, s'ka problem. Iki me autobus, nuk ka nevojë për avion. Ai ishte krenar, ai ishte luftarak dhe luftoi, luftoi shumë deri në fund. Mblodhi forcat dhe erdhi të merrte edhe titullin "Nderi i Kombit". Dy ditë më vonë u bë më keq derisa na la. Sëmundja avancoi shumë sidomos muajin e fundit.

- A ka lënë ndonjë porosi a ndonjë amanet, apo nuk e mendonte që po vinte fundi?

Amanetet ai ia ka lënë familjes së vet, gruas, vajzave dhe dhëndurëve që i ka të shkëlqyeshëm. Mendoj se amaneti i tij është i thjeshtë. Amaneti i vetëm i Xhepit është vallja. Vëllai im e thotë: kurrë vallja të mos ndalet. Kjo është porosi e mendimi i Rexhep Çelikut: të mos ndalet vallja, pavarësisht se kjo dihet për të gjithë ne që jemi artistë. Unë siç e thashë vallen do ta vazhdoj derisa këmbët të më lënë dhe të fluturoj edhe unë drejt qiellit si Rexhep Çeliku.

- Në 50 vite në skenë, cila ka qenë vallja juaj më e dashur?

Vështirë të ndash vallen nga vallja. Por më e bukura në Ansambël është momenti kur hapet perdja dhe del një çift që hap krahët dhe performojnë shqiponjën. Të kërcesh një valle epike, si: "Luftëtarët e lirisë", një Shote e Azem Galicë, por edhe një valle Tirane është e bukur. Unë meqë kam një origjinë nga Kosova, më pëlqente edhe vallja e Rugovës.

VLERËSIMET

- Ka meritуar dhjetë çmime të para "Si interpretuesi më i mirë".
- Në vitin 1978 dekorohet me Medalje ari në Itali si valltari më i mirë i Festivalit Ndërkombëtar.
- Në vitin 1996 dekorohet në Itali me Medalje argjendi.
- Në vitin 2000 merr çmimin e dytë në Festivalin Folklorik Botëror
- Në vitin 2000 dekorohet në Maqedoni (FYROM) me Medalje dhe Çmim të parë si koreograf.
- Në vitin 1983 dekorohet me urdhrin "Naim Frashëri" i klasit të dytë.
- Në vitin 1987 dekorohet me urdhrin "Naim Frashëri" i klasit të Parë.
- Më datën 18. 11. 2005, i jepet titulli "Nderi i Qarkut të Tiranës".
- Më datën 8.12.2005 Presidenti i Republikës, Z.Alfred Moisiu, e nderon me titullin "Mjeshtër i Madh".
- Në vitin 2011 nderohet me titullin e madh "Ambasador i Paqes".
- Më 7 mars 2012 dekorohet në Maqedoni (FYROM) me titullin "Simbol i Paqes dhe i Lirisë".
- Më 8 janar 2018 dekorohet me urdhrin "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës, Ilir Meta.

Opinioni i Ditës

Policia që meritojmë

Nga Besnik Bakiu

(Vijon nga faqja e parë)

... Qemali, vendosi krijimin e Forcave të Ruajtjes së Rendit, detyrë të cilën ia ngarkoi luftëtarëve të shquar S.Vranishti, A.Tragjasi, H.Toska, H. Hekali, etj.; kurse si drejtor të parë i policisë shqiptare nderi dhe përgjegjësia i takoi Halim Gostivarit.

Ky vendim u shoqërua me 2 akte të tjerë, me rregulloren "Për funksionimin e Milicisë Shqiptare' dhe dekretin "Mbi formimin e Xhandarmërisë Shqiptare". Rëndësia e këtyre akteve qëndron në faktin se për herë të parë u hodhën bazat institucionale të Forcave të Rendit, si dhe u mëtua për t'u shkëputur nga tradita e vjetër ligjore osmane drejt Perëndimit.

Në nderim të faktit dhe dokumentit historike duket përmendur se "Qeveria e Vlorës" i dha rendësi të veçantë konceptit të sigurisë, si një prej sfidave më të mëdha të ekzistencës si shtetit, kombit dhe vetë identitet kombëtar. Kjo vëmendje shfaqet dhe përcillet qartë edhe në telegramet e para dërguar prefekturave dhe nënprefekturave, ku Ismail Qemali, pasi njofton për shpalljen e Pavarësisë, porosiste: "... Lutemi ... përpiquni të siguroni sa më mirë qetësinë e vendit dhe rendin publik", "Është e nevojshme të bëhet një reformim në çështjen... e qetësisë publike".

13 janari është caktuar si dita e "Forcave të Ruajtjes së Rendit", pasi kjo datë e shënuar lidhet me historikun e strukturave që u është ngarkuar kjo detyrë e cila, në periudha të ndryshme kohore ka cilësuar me emra të ndryshëm, në përkatësi termave të kohës, herë si milicia, herë si policia dhe herë xhandarmëria.

Duke studiuar arkivat për këtë shkrim, më bëri përshtypje moderniteti dhe finesa e legjislacionit e hershëm të policisë shqiptare, madje, për të qenë i sinqertë u ndjeva disi në faj për problematikën jo të vogël të legjislacionit policor "post-diktaturë". Në "Rregulloren mbi detyrat e Policisë", miratuar nga Kongresi i Lushnjës në vitin 1921, parashikohen norma të Kodit Etik dhe Sjelljes të zyrtarëve të policisë, ku mes të tjerave atyre punonjësve u ndalohej kategorikisht "konsumimi i pijeve alkoolike, futja në pijetore, kafene e klube, vendet e kumarit ose lojërave publike", për të mos përmendur këtu qëndrimin dhe etikën e uniformës në paraqitjen publike. Ky Kod i atëhershëm të bën të ndërosh lidhjen etimologjike që fjala polic ka me fjalën qytet (nga greqishtja e vjetër polis), si një detyrim i tyre ndaj sjelljes qytetare.

Gjithashtu, u befasove kur vite më parë vura re se një ndër drejtuesit e policisë të asaj kohe ishte edhe veprimtari dhe përhapësi i çështjes kombëtare, letrari dhe politikani Hil Mosi, apo kur më vonë, gjatë hulumtimeve të mia, mësova se drejtor drejtorie në Ministrinë e Brendshme ka qenë edhe dramaturgu i shquar Et'hem Haxhiademi, i cili përfaqëson ndër të rrallët tragjedianë shqiptarë që solli antikitetin në shekullin XX dhe u arrestua e u dënua me vdekje në kohën e diktaturës.

Në këtë 105-vjetor të Policisë së Shtetit, nderimi dhe mirënjohja e parë shkon për të rënët, atyre njerëzve që dhanë jetën duke qenë në radhët e policisë. Bashkë me ta, nderimi shkon edhe për të plagosurit në krye të detyrës, të cilët, të gjithë së bashku, për fat të keq kalojnë në numër ata të një lufte. Emrat e atyre që dhanë jetën do të kujtohen në përjetësi, pasi asnjëri prej tyre nuk shkoi drejt vdekjes me dëshirë për t'u shpallur "Dëshmor", por kur vdekja u erdhi pranë, ata nuk u frikuan, se nuk kishin kohë të mendonin as për të, duke e sfiduar atë.

Po të ndjekësh transformimin e policisë në vite, të bie në sy roli i qenësishëm, që ka luajtur faktori ndërkombëtar në forcimin e modernizimin saj. Ky kontribut ka qenë i pranishëm që në fillesat e saj me misionin holandez të kryesuar nga William de Veer dhe zëvendësi i tij Ludvig Thomson, vazhdoi me misionin britanik të kryesuar nga Gjenerali Sir Jocely Perscy dhe është i pranishëm edhe sot me programet e misionet ICITAP, PAMECA, FRONTEX, SEPCA, DCAF, SELEC,CEPOL, INTERFORZA dhe Guarda di Finanza, OSBE, SCPA, etj.

Prandaj në këtë ditë feste nuk mund të lëmë pa kujtuar e vlerësuar me nderim veprën e miqve tanë ndërkombëtarë, pasi mendoj se ende nuk e kemi tejkaluar gjestin nderues të Imzot Fan Nolit, që në poezinë "Tomsoni dhe Kuçedra" na e përkujton më bukur se çdo epitaf i munguar: "Dhe hovin kuçedrës ia preve, po re / Kalorës i huaj që vdiqe për ne!".

Në këtë përvjetor, nderimi shkon, gjithashtu, edhe për veteranët e policisë, të cilët me punën, kontributin dhe sakrificat e tyre, të imponojnë vetëm mirënjohje e respekt.

Por mosha 105-vjeçare dhe nderimi që të imponon kjo moshë, nuk do të thotë të kyç vesh e gojë dhe të mbyllësh sytë, qoftë edhe në ditë përkujtimore si kjo. Shkruaj kështu pasi sot, edhe në ditën e përvjetorit të saj të 105-të, Policia Shqiptare nuk është në ditët e saj të mira, madje përkundrazi ajo është e akuzuar, e përfolur dhe e anatemuar. Pa dashur të bëj avokatin mbrojtës të askujt, nuk mund të rri pa shprehur mendimin se me gjithë borxhet që mund të ketë Policia e Shtetit, përsëri punonjësit e saj janë nga më atdhetarët dhe më të përkushtuarit e shoqërisë shqiptare. Kjo nuk përjashton faktin se individë të veçantë të inkriminuar mund të ketë edhe në radhët e saj, por ju siguroj se ata nuk kanë asnjë lidhje shpirtërore e profesionale me policinë, përkundrazi, për mendimin tim, (dhe jo vetëm) ata me anë të lidhjeve dhe kontributeve të dyshimta "extra policore" i janë imponuar policisë dhe e kanë shfrytëzuar atë. "Hienat e ndjejnë shpejt erën e viktimës".

Të habit fakti që të gjithë i janë vërsulur policisë dhe askush nuk kujtohet për kontrollin e munguar nga SHKB, e cila paguhet nga taksapaguesi për zbulimin dhe dokumentimit të veprimtarisë kriminale që kryhet nga punonjës të Policisë Shtetit. Unë si ish-drejtues i këtij shërbimi(i dorëhequr) dhe si i ndjekur abuzivisht nga ai, do të kërkoja që minimalisht të bëjnë një "mea culpa".

Në këto vite post-diktature policia shqiptare është ndeshur me shumë të përpjeta e tatëpjeta dhe gjithmonë më ka ngelur pa përgjigje pyetja "Pse nuk i ka interesuar politikës shqiptare krijimi i një institucioni të fortë policie?" Do ta përdorë, apo ka frikë nga inkriminimi i vet? Apo të dyja bashkë? Siç duket, raporti frojdian i urrejtjes midis zbatuesit të ligjit dhe antiligjit ka qenë mbisundues. E them këtë për këto arsye:

- Mungesa e një konsensusi politik për të krijuar një Polici Shteti të qëndrueshme, të aftë profesionalisht dhe të depolitizuar. Vetëm ligji për Policinë e Shteti, është ndryshuar 5 herë dhe votuar vetëm nga mazhorancat e radhës, madje në dy herët e fundit pjesë të tij janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

Kësaj i shtohen edhe qasjet krejt të kundërta pozitë-opozitë për punën, rezultatet dhe profesionalizmin e drejtuesve të policisë. Opozita e radhës e vendos Policinë Shtetit në epiqendër të akuzave, sikur të ishte e keqja më e madhe e këtij vendi, kurse pozita e mbron me një retorikë bombastike, sikur Shqipëria është "ndër shtetet me treguesit më të mirë në luftën kundër kriminaliteti, jo vetëm në rajon, por më gjerë".

- Keqpërdorimi politik i policisë, për këtë mjaften të shikosh paradat e ministrave apo zv/ministrave në konferenca shtypi edhe për aksione të veçanta policore, habitesh. Thua vërtetë nuk e dinë se funksioni i tyre është politik dhe jo operacional? Nuk mund ta besoj, që e bëjnë nga padija.

- Policia dhe të qenit polic, pavarësisht nga grada, ka ngelur i vetmi ndër profesionet, që është penguar artificialisht të krijojë elitën e saj. Në këtë "shtatore migjeniane" politikën e ndihmoi e kudondodhura në antiligj, gjykata, me vendimet e saj për dhënie grada policore.

Gjatë 27 viteve ka ndodhur jo rrallë që njerëz pa asnjë lloj kontributi janë bërë drejtues dhe e kundërta. Kanë ndodhur kërcime të tilla në karrierë (për merita jo policore), që do t'i kishte zili edhe rekordmeni i botës në kërcim me shkop Sergej Bubka.

- Mungesa e respektit dhe solemnitetit ndaj institucionit të policisë. Sipas rregullave, kur i komunikohet detyra Drejtorit të Përgjithshëm, bëhet edhe ceremonia e dorëzimit të flamurit të policisë. Nuk është nderuese, madje është e turpshme, që ky flamur deri tani është marrë për herë të parë nga zoti Bilbil Mema dhe nuk është dorëzuar më asnjëherë. Asnjë nga drejtorët e policisë nuk ka mundur të përfundoj mandatin e tij ligjor, madje gjatë periudhës postdiktoriale janë ndryshuar mbi 16 të tillë.

Po t'i shtosh kësaj faktin se janë të rralla rastet kur mund të kesh "fatin" të takosh ndonjë punonjës policie të dalë normalisht në pension. Imagjino kur në një institucion që përgjigjet për sigurimin e zbatimit të ligjit dhe kur dhunimin e ligjit nga një qytetar i thjeshtë e quan krim, dhunimin e ligjit nga titullarët e saj e quan reformë, madje edhe pa e kuptuar dhe interpretuar domethënien dhe jo më etimologjinë e fjalës reformë.

Në këtë kuadër më vjen në kujtesë një ngjarje të jetuar nga një miku im, ish-drejtues i Policisë Shtetit. Vetëm pak kohë pas realizimit të një operacioni të suksesshëm, ku u kap një sasie e madhe droge, me inskenime nga më banalet dhe në mënyrë të kundërligjshme, ai arrestohet dhe futet në të njëjtën qeli me trafikantin që kishte arrestuar disa ditë më parë. Trafikanti i thotë: "Shef më arrestove mua, ja ku erdhe edhe vet këtu. Ky është shteti, shef?". Pra, e kuptoni çdo të thotë të humbasësh besimin te shteti yt, për të cilin ke sakrifikuar jo pak. Është dërrmues ky fakt dhe, të mos harrojmë se historia botërore ka jo pak precedentë kur ish-zbatuesit e ligjit, të zhgënjyer dhe tradhtuar nga shteti i tyre, janë bërë të vështirë për t'u kontrolluar.

- Reformimi dhe ristrukturimi non stop i Policisë, madje nga 2-3 në vit (korr e mos lidh). Sipas meje në pjesën më të madhe të tyre, në këto reforma janë konstatuar probleme të mëdha etike, metodike dhe teorike, si dhe janë karakterizuar nga nepotizmi, klientelizmi, krahinalizmi dhe antiligji. Mendoj se ka ardhur koha të heqim dorë nga ora "0" dhe të fillojmë të numërojmë në mënyrë demokratike. Pra, nëse paraardhësi e ka lënë te dyshi, pasardhësi duhet të fillojë të numërojë te treshi dhe jo më te njëshi. Duke ju përmbajtur sindromës "kopsës së parë mbërthyer keq", reforma e re, ka lindur një reformë të dytë dhe kjo e fundit ka pjellë një reformë të re, e kështu pambarim... "Selanik e tatëpjetë, siç ka qenë, do të jetë".

Këtij reformimi nuk i kanë shpëtuar as uniformat dhe simbolet, të cilat janë ndryshuar 5 herë, në këto 27 vite.

- Mbivlerësimi i rolit të policisë në shoqëri. Në demokracitë perëndimore misioni ligjor i policisë është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, të mbrojë jetën e njerëzve, sigurinë dhe pronën e tyre personale; por në Shqipëri, ky mision, në mënyrë të padrejtë, zgjerohet dhe policia barazohet me vetë shtetin, si dhe shërbimet e tjera publike. Por ka ardhur koha që gjithë secili të përgjigjet për detyrën për të cilën paguhet nga taksapaguesi.

Në këtë ditë feste do të dëshiroja modestish të bëja disa apele dhe jepja disa sugjerime:

-Shoqëria të ndjejë detyrimin moral të bashkëpunimit me policinë kundër krimit, pasi nëse shoqëria nuk vepron, ngjarje kriminale, mund të përsëriten çdo kohë; si dhe respektit për figurën e policit, duke mos harruar se dhe ai është njeri me problematikat dhe vështirësitë që ka jeta e gjithë secilit nga ne, se edhe ai ka të përditshmen e vet në këtë Shqipëri të lodhshme e të drobitur. Dhe pavarësisht të gjitha këto ai në punën e tij i takon të përplaset me kriminelë, hajdutë, dhunues, të droguar dhe me lloj-lloj natyrash të vështira njerëzish, të prirur për të kryer akte kriminale.

Duhet të sjell në vëmendje se policia e ushtron veprimtarinë e saj në një shoqëri ku kultura ligjzbatuese është e mangët dhe shkelësit e ligjit janë në mazhorancë. Kësaj i shtohet edhe një mjedisi politik shumë të ndotur dhe agresiv.

-Do t'u kërkoja miqve të mi punonjës policie të duam, respektojmë më shumë njeri -tjetrin dhe të kemi etikë në çdo komunikim. Punonjësi i policisë nuk është një punonjës i zakonshëm. Ai është një emblemë, një përfaqësim. Çdo organizatë në botë, sidomos ato policore kanë si parim bazë të ekzistencës tyre, vlerësimin dhe respektin ndaj anëtarëve të vet.

-Misioneve të huaja policore (duke qenë mirënjohës për ndihmën e dhënë), u sugjeroj, të jenë më aktivë dhe më konkret në ndihmën e dhënë, pasi në ndonjë rast ndonjëri më kujton Penelopën te filmi "Odisea". Të flasin në kohën dhe momentin e duhur dhe jo të mjaftohen vetëm me evidentimin e gabimeve, për të plotësuar raportin vjetor të tyre, pasi, siç thotë poeti i madh, miku im Xhevahir Spahiu në poezinë "Fjala" "E ç'më duhet kur s'u thashë atëherë kur duhej?" U sugjeroj të jenë më të drejtpërdrejtë.

-Drejtueseve të Ministrisë Brendshëm, duke uruar suksese në detyrë, dhe besuar në kryerjen e një reforme të studiuar, qëndrueshme, afatgjatë dhe me standard, për një Polici Shteti dhe jo polici pushteti; u sugjeroj të bëhen avokat dhe jo prokuror i Policisë së Shtetit. Këtu dua të kujtoj thënien e shkrimtarit të madh Viktor Hugo: "Të jesh i mirë është e lehtë, vështirë është të jesh i drejtë...."!

Po ashtu të nxisin daljen e akteve për të drejtat e punonjësve të policisë, që ka 4 vjet që ia jep ligji, si të drejtat për përfitim kredie me interesa të butë, kompensimin për strehim, sigurimi i jetës, pension shërbimit etj. Personalisht mendoj se do të ishte imediat miratimi i ligjit për pensionin e shërbimit, i cili do të ndikonte në uljen e moshës mesatare të organizatës.

Gjithashtu, ka ardhur koha të hapin dyert për rekrutimin e kontingjenteve të diplomuar në shkencat juridike, sociale, ekonomike, kompjuterike, etj. dhe të riten investimet në pajisje dhe teknologji, pasi krimi është sofistikuar dhe ka rritur financat e veta.

Në përfundim, duke perifrazuar burrin e madh dhe të mençur Thomas Jefferson se: "Çdo popull meriton qeverinë që ka", mendoj se "Çdo popull meriton edhe policinë që ka".

Dje/në 'Deutsche Welle'

Të nxitur për rezultate, CDU, CSU dhe SPD, ujdi për koalicion

Nga Christoph Strack

(Vijon nga faqja e parë)

... mes ka luajtur presidenti, mendon Christoph Strack.

Ata duhej të binin dakord. Dhe e bënë këtë. CDU, SPD dhe CSU tani duan të hyjnë në koalicion, nëse pas nëntë ditësh kongresi i SPD-së do ta miratojë këtë. Pas katër ditësh me "një atmosferë të mirë" - sinjalesh të negociuesve u desh edhe një maratonë bisedimesh 23-orëshe, e pazakontë kjo deri më sot për krijimin e qeverisë në Gjermani. E pra, ja që kështu ndodh.

Tani ka një paketë. Ajo duket më shumë si një skicim i marparti. E në pjesë të caktuara ai të befason: "Europa" është - një sinjal shumë i rëndësishëm ky - jo më një temë në faqet e pasme të dokumentit, por ajo është hyrja në tri faqe thelbësore për një "hov në politikën europiane". Politika e jashtme krahasuar me këtë renditet pas, por sidoqoftë në këtë fushë përjashtohen eksportet e armëve në vendet që janë të involvuara në luftën në Jemen.

Sa i përket hovit në politikën e brendshme, këtu bën pjesë një "pakt për shtetin ligjor", "për drejtësinë". Tani nuk do të ketë rritje të taksave (gjë që e kërkonte SPD-ja). Por nga ana tjetër, sigurimi ligjor shëndetësor (një grindje kjo që vazhdon prej vitesh) do të vazhdojë si deri më sot të financohet një pjesë nga punë-

Ajo që bie në sy është roli i presidentit deri në ditën e fundit të konsultimeve. Ujdia e së premtes është një rezultat i presionit që ushtroi kreu i shtetit në kohë serioze politike. Kjo bën që të forcohet rëndësia e postit, i cili rëndom konsiderohet si pa pushtet. Por, Frank-Walter Steinmeier këtë javë e shfrytëzoi momentin gjatë pritjeve me rastin e Vitit të Ri që të përdorte fjalë të qarta për t'u tërhequr vëmendjen negociuesve. "Të gjitha vështrimet janë drejtuar nga partitë dhe përfaqësuesit kryesorë të tyre", tha ai të martën. "Të gjithë pyesin se si duhet dhe mund të vazhdohet tani - e kjo pyetje shtrohet me plot të drejtë". Atë e dëgjuan kryetarja e CDU-së, Angela Merkel e shumë anëtarë të kabi-

dështuan bisedimet paraprake për koalicion me partinë liberale dhe ekologjistët. Por, ky mesazh vlejti edhe për këtë javë. Njëkohësisht, kjo nënkuptonte për Merkel, Schulz dhe Seehofer që ata duhet të bien dakord.

ENDE KA PENGESA TË TJERA QË DUHEN KAPËRCYER

Kjo natë nga Berlini nuk sjell më shumë se sa një stand të ri të ndërmjetëm. Nëse krijimi i qeverisë që nga fundi i shtatorit konsiderohet si një vrapim me pengesa, atëherë ujdia në negociatat paraprake për koalicionin ishte vetëm një pengesë e vogël në sfondin e pengesave që priten në kongresin e SPD-së më 21 janar në Bon. E nëse kapërcehen këto pengesa, atëherë

rëveshjes së koalicionit se sa një ujdi për parimet bazë të një programi të përbashkët qeveritar, që duhej peshuar gjatë bisedimeve paraprake. "Ne duam ta ripërtërijmë kohezionin", thotë kryetari i SPD-së, Schulz. Dhe kancelarja Merkel e cilëson dakodrimin si një premisë që "ne në Gjermani të mund të jetojmë mirë edhe në dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjet".

TË GJITHA PARTITË DUHEJ TË TËRHIQESHIN

Dokumenti është shumë më i detajuar nga sa pritej. Duket qartë se ku duhej të lëshonte pe secila marrësi dhe një pjesë nga punëdhënësi. Po ashtu, duhet të ketë një pension solidariteti. Por, kuotizacioni i solidaritetit për landet e reja (pas bashkimit të Gjermanisë sh. red.) gradualisht do të hiqet. Po ashtu të bie në sy përcaktimi i një kuadri të ngushtë për temën e refugjatëve. Kjo fillon qysh me termat "azil", që këtej e tutje do të trajtohet si "imigracion". Bashkimi familjar parimisht është parashikuar dikur, por me kufizime.

KAQ SHUMË PESHË PRESIDENTI NUK KA PASUR KURRË MË PARË

netit qeveritar, po ashtu edhe kryetari i SPD-së, Martin Schulz.

Të enjten para pritjes së trupit diplomatik presidenti shtoi: "CDU, CSU dhe SPD janë të detyruara jo vetëm për partitë e tyre dhe të ardhmen e politike të tyre, por ato kanë edhe një përgjegjësi të madhe për Europën dhe politikën ndërkombëtare". Prej kësaj u kuptua dhe një mesazh i qartë që Steinmeier, çfarëdo që të ndodhë mbështetet tek parlamenti. "Kush aplikon për përgjegjësinë politike nuk duhet të tërhiqet", u shpreh presidenti para dy muajsh, kur do të pasojnë bisedimet formale për koalicionin. Por ajo që mbetet është se Kushtetuta zyrtarisht nuk njeh as bisedime koalicioni dhe as bisedime paraprake. Drama e tanishme nuk duhet që pas kongresit të SPD-së, të vazhdojë edhe në bisedimet zyrtare për koalicionin qeverisës. Kjo për arsye se Gjermania pas gati katër muajsh të zgjedhjeve parlamentare, ka nevojë për një hov, për një sinjal. Njerëzit presin që prej 100 ditësh për këtë. Kjo e premte sjell në disa detaje surpriza, një sinjal. Ato tani vetëm duhet të bien dakord.

HOROSKOPI

DASHI

Lëvini butësinë që të rrjedhë lirisht. Do të shërbejë për të çimentuar një lidhje të konsoliduar ose të shkrijë ndrojtjen në një marrëdhënie të porsalindur. Në punë do t'ju duhet të pranoni disa kompromise: solidariteti është i barasvlershëm me suksesin e ndërmarrjeve.

DEMI

Do të jeni të suksesshëm në shkollë dhe në punë. Ndoshta në të vërtetë ndiheni të pakënaqur, por kur ke fantazi e tejkalon mërzitjen! Venusi plot gjallëri, gjatë ditës ju mbështet ëmbëlsisht ëndrrat dhe dëshirat, ndërsa në mbrëmje ju sjell me këmbë në tokë.

BINJAKET

Në dashuri do të tregoheni pak posesiv si edhe do të ndikoheni nga kritikat dhe pakënaqësitë në familje. Jeni të qetë, vetëm miqtë ju mundësojnë ekuilibër. Do të keni disa shpenzime të mëdha për shtëpinë: bëhet fjalë për punime mirëmbajtjeje.

GAFORJA

Në kontakt me publikun jeni gjithmonë të preferuar, buzëqeshja juaj lehtëson barrën dhe shkrin pakënaqësitë e atyre që janë në pritje. Do të kaloni një mbrëmje shumë të bukur dhe argëtuese në shtëpinë e miqve të juaj.

LUANI

Do të keni krijimtari të rafinuar. Arti, fotografia dhe muzika nuk janë thjesht hobi, por mund të kthehen mundësi profesioni. Planetët bashkëveprojnë për t'ju mbështetur. Do të keni shumë energji, pasion dhe besim në aftësitë e juaj krijuese.

VIRGJERESHA

Do të mbizotërojë shpirti i skuadrës me kolegët, kur njëri nuk ia del e ndihmon tjetri, pa zili dhe kritika, për të arritur objektivin. Investimet do të duhet të monitorohen: konsultohuni me një ekspert të kësaj fushë. Do të bëni blerje interesante në librari.

PESHORJA

Është dita ideale për ata që kanë dëshirë të bëjnë punime: në shtëpi keni me të vërtetë shumë punë për të bërë. Mjetet dhe materialet do të jenë të kushtueshme, por do t'ia vlejnë. Edhe në zyrë atmosfera është e qetë, të gjithë mendojnë për punën e tyre pa ndërhyrë në até të të tjerëve.

AKREPI

Mërkuri miqësor në bashkëveprim me Neptunin, krijojnë situatën ideale për të bërë paqe me partnerin, nëse do të ishte e nevojshme, dhe të t'i ktheni përsëri buzëqeshjen njëri-tjetrin. Ndërkaq, është thelbësore që të përballeni gjithmonë me të vërtetën.

SHIGJETARI

Do të jeni me miq dashamirës dhe përkrahës, me të cilët do të vendosni të organizoni një takim të bukur. Mes artit dhe natyrës, të bashkëpunosh është edhe më e lehtë. Shpenzime të paparashikuara në punë, kompjuteri dhe printeri kanë nevojë për ndërhyrjen e një tekniku.

BRICJAPI

Do jetë një ditë shumë e qetë dhe paqësore, e dobishme për ata që kanë punë të ngutshme për të bërë ose që duhet të bëjnë punime në shtëpi. Sot është i rëndësishëm edhe kontakti fizik: Me një ledhatim shprehni të gjithë thellësinë e ndjenjës.

UJORI

E mendjen e turbullt, mes fantazive të parealizueshme dhe projekteve të cunguara. Nëse kërkoni gjëra, dhe është mirë që e bëni, mbështetja nuk do t'ju mungojnë. Ajo që mungon sot është në veçanti dëshira të hyrë në lojë, duke shfrytëzuar kapacitetet e juaja.

PESHQIT

Hëna ju bën të ndiheni të sigurt. Do të shfaqni prova të mëdha të miqësie dhe idealesh të përbashkëta me të njohurit. Do të tregoni gatishmëri drejt një kolegu, i cili po kalon nëpër një fazë të vështirë. E dini që vepra do t'ju shpërblehet.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Dillon aktor.
5. Një listë që zgjidhet nga regjisori
9. Sigla e tritolit.
12. Kapiteni që ndiqte balenën Moby Dick.
14. Eshtë spektator i yni.
16. Fillojnë lejen
17. Një sinjal akustik.
19. Një parashtesë për... përtej.
20. Eshtë partia e Sali Berishës.
23. Kanë organizatën Hamas.
24. Gëlojnë nga murgjit.
25. Në teori kur mungon ti.
27. Inicialet e Gide.
28. Inicialet e Asimov.
29. Nisen pa ne.
31. Kreshniku i volejbollit.
36. Kufijtë e tokës.
37. Mund të jenë autonome të tilla.
38. Britma e Arkimedit.
41. Fillojnë vetëm.
42. Bota jashtë ëndrrës.
44. Mund të jenë ushtarake.
46. Italia në Internet.
47. Gjysmë atomik.
49. Janë prova inteligjence
50. Një libër hartash.
51. Clapton i muzikës.

VERTIKAL
1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një... bombë tenistike.
3. Fillojnë themelet.
4. Mund të jetë klasifikimi.
6. Një letër... kampioni.
7. Eshtë pozicioni për gjumë.
8. Janë diktatorët despotikë.
9. Një kryeqytet afrikan.
10. Qe mesfushor i famshëm i Ajax.
11. Ekstreme në tenis.
13. Eshtë e dendur në xhungël.
15. Eshtë brinjë në skuadër.
18. Eshtë pako që dërgohet.
20. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
21. Bëjnë taktika me taka.
22. Vetot pa kufij.
23. Persekutonin romakët.
24. Eshtë gri ajo e trurit.
26. Një mund të jetë spiunzhi.
30. Janë vendet për nisje.
32. Me to bëjnë torta.
33. Janë katër në kitarë bas.
34. Institucione Urbane Rajonale.
35. Priten me lotë në sy.
39. Një rreth pa ekstreme.
40. Gjysmë kasate.
41. Eshtë cilësia.
43. Ente Tregtare Lokale.
45. Një pjesë e territorit.
48. Në hyrje të oazit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Jagger i Rolling Stones.
4. Zanore për kuaj.
6. Janë dhelpra.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Kufizojnë rastet.
14. Mbyllen me epilog.
16. Eshtë simbol ngadalësie, por jo breshkë.
18. Gjysmë njeriu.
20. Janë fruta ekzotikë.
21. Një minierë e vjetër.
23. Ata tanë ishin ilirë.
24. Masat pa kufij.
25. Një gëzim i madh.
26. Agjenci Ndërmjetëse Përmet
27. Eshtë godinë në miniaturë
29. Film i Ridley Scott
31. Duken të gjata në pritje.
32. Njëzetmijë... në det në një libër të Jules Verne.
34. Eshtë kreu i bandës.
36. Ndahen nga ortakët.
38. Eshtë numri një.
41. Janë trupa qiellorë të tillë.
44. Kanë dhoma për t'u zënë.
46. Tri çupa në poker.
47. As unë, as ai.
48. Janë vitet.
49. Pak amatoriale.

VERTIKAL
1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Nuk e ulin kokën.
5. Këndohen në opera.
6. Janë tek në Somali
7. Eshtë lloj papagalli.
8. Mbyllin komentin.
9. Eshtë e parë për prodhim.
10. Kush ka do të pijë.
13. Janë binarë.
15. Rolet pa ret.
16. Vihen për të mbyllur të tilla.
17. Janë tek në mantel.
19. Salgari që krijoi Sandokan.
20. Një stinë e ngrohtë.
22. Janë pamje nga puna.
26. Një fjalë goxha.
27. Ato Ëilliams janë teniste
28. Ishin të parët tanë.
29. Janë edhe ato polare.
30. Fillojnë nazet.
33. Inicialet e Triolet.
36. Një bëhet me pozë.
37. Mbyllin punimet.
39. Ndodh në kufij.
40. Perignon i champagne-s.
42. Eshtë iks ajo e sulmit.
43. Enti europian i hapësirës.
45. Fillojnë lehtë.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

			9			4	5	8
7		3			8	2		
	8			1	4			6
		5		8			1	9
		6	1		2	5		
4	7			9		8		
1			5	2			4	
		4	7			9		3
9	6	7			3			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	1	4	9	6	8	2	3	5
5	9	2	1	3	7	4	8	6
3	8	6	5	4	2	7	1	9
2	3	1	4	7	9	6	5	8
4	6	9	8	5	1	3	7	2
8	7	5	6	2	3	1	9	4
6	2	7	3	8	5	9	4	1
1	4	8	7	9	6	5	2	3
9	5	3	2	1	4	8	6	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

DA VINÇI

- Nuk është e bukur ajo që është e bukur, por e bukur është ajo që ju pëlqen.
Italiane
- Fillimi i mirë - garanci e mbarimit të mirë.
Fishart
- Siç nuk mund të qortohet veprimi i pavetëdijshëm, kështu nuk mund të lëvdohet as mirëbërësia e detyruar.
Euripidi

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	A	F	O		M	A		M		L	A	F
A	N	A		K	O	S	T	U	M	E		R
R		K		A	K	T	O	R	I	A	L	E
A	L		K	L	E	O	P	A	T	R	A	
F	U	K		I	T	R	E	T	I			S
	L	A	N	G	E		K	I		B	F	K
B	U	R	G	U		A	A		A	R	I	U
A		T	A	L		N		U	R	A	T	A
S	K	E	D	A	R	E		A	A		O	D
M	I	L	L	A		O	M	E		B	U	R	R
A	N	A	L	I	T	I	K	E		L	E	A
T	A	T	E		A	K	T	O	R	I		T

FJALËKRYQI (1) DHE FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	T	T		C	A	S	T		T	N	T
A	C	H	A	B		S	H	I	K	U	E	S	I
L	E		R	T		R	O	M	A	N	E	T	
I		D	E	M	O	K	R	A	T	I	K	E	
	P	A	L	E	S	T	I	N	E	Z	E	T	
M	A	N	A	S	T	I	R	E	T		E	O	R
A	G			I	A		E		I	S	N		R
T	A	R	T	A	R	I		Q		T	S		J
E	N	T	E		E	U	R	E	K	A		V	E
R	E	A	L	E		R	E	P	A	R	T	E	T
I	T		A	T	O		T	E	S	T	E	T	
A		A	T	L	A	S		T		E	R	I	C

FJALËKRYQI (2) DHE FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	I	C	K		U	A		S	K	I	L	E	T
I	L		R	T		R	O	M	A	N	E	T	
T		K	E	R	M	I	L	L	I		N	J	E
	B	A	N	A	N	E	T		M	A	D	E	M
T	E	P	A	R	E	T			A	S	A		I
	H	A	R	E			A	N	P				L
M	A	K	E	T	I		A	L	I	E	N		I
O	R	E	T		L	E	G	A		K	A	P	O
T				F	I	T	I	M	E	T		A	
R	E	N	D	O	R		M	E	T	E	O	R	E
A		H	O	T	E	L	E	T		T	R	I	S
T	I		M	O	T	E	T				A	M	A

Thënie të mençura

- Guximi ndërohet me të drejtë, si e para nga cilësitë njerëzore, pasi është cilësia që garanton të gjithë të tjerat.
(Uinston Curcill)
- Sa barrë e rëndë është një emër që është bërë shumë i famshëm. **(Volter)**
- Nëse asnjë s'të ka zili, dije se ti je njeri i dështuar. Pema me kokrra synohet, tjetra harrohet...
- Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u biesh.
(Ralf Valdo Emerson)

EKSKLUZIVE

"FAIR PLAY" nga Enkeleida Zeko
Z.Armand Duka live në "News 24"

FAIR PLAY

Të dielën në 14 Janar, ora 22:00

news 24